



AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

ANALIZA VJETORE 2014




Ky raport pasqyron punën e Agjencisë së Prokurimit Publik dhe funksionimin e Sistemit të Prokurimit Publik për periudhën nga 1 Janar 2014 deri në 31 Dhjetor

1. HYRJE

Ky raport pasqyron punën e Agjencisë së Prokurimit Publik (këtu e në vijim “APP”) dhe funksionimin e sistemit të prokurimit publik për periudhën nga 1 Janar 2014 deri në 31 Dhjetor 2014.

Gjatë vitit kalendarik 2014, APP e ka ushtruar veprimtarinë e saj në bazë të Ligjit Nr. 9643/2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 125/2013 “Për konçesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 9874/2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar si dhe në bazë të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 143, datë 06.07.2010 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Konkretisht, struktura e APP-së është si më poshtë:



2. ASISTENCA E PROJEKTEVE TË HUAJA

Gjatë vitit 2014, APP nuk ka qënë pjesë e ndonjë projekti të financuar nga donatorë apo organizata ndërkombëtare.

Megjithatë, sikurse dhe në vitet paraardhëse, edhe gjatë këtij viti, APP ka vazhduar të asistohet nga SIGMA (Programi për Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit në Evropën Qendrore dhe Lindore) për përmbushjen e detyrimeve të saj në kuadër të procesit të integrimit evropian.

Gjatë këtij viti, asistenca e SIGMA-s ka qënë e fokusuar kryesisht në hartimin e Strategjisë mbi Sistemin e Prokurimit Publik në Shqipëri, e cila më pas u përfshi në Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Financave Publike, 2014-2020, e miratuar nga Këshilli i Ministrave në muajin Dhjetor 2014. Pjesa e prokurimit publik në strategjinë e sipërcituar përcakton qëllimet kryesore

në zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të prokurimeve dhe masat e nevojshme për realizueshmërinë e tyre.

Gjithashtu, gjatë këtij viti SIGMA ka dhënë një asistencë shumë të vlefshme për projekt ndryshimet në ligjin e prokurimit publik, duke shprehur komentent dhe sygjerimet e saj, me qëllim përafrimin e këtij të fundit me Direktivën përkatëse të Bashkimit Evropian.

Vlen të theksohet se, gjatë këtij viti SIGMA ka asistuar APP-në në drejtim të marrjes së masave (ligjore dhe në drejtim të ngritjes së kapaciteteve administrative) për stimulimin e zbatimit në praktikë të Marrëveshjes Kuadër.

3. INICIATIVAT LEGJISLATIVE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK GJATË VITIT 2014

3.1. Ndryshimet legjislative

Gjatë vitit 2014, APP ishte pjesë e një grupi pune të përbërë nga institucione me rol kyç në fushën e prokurimit, nën drejtimin e Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, i ngritur me qëllim hartimin e disa ndryshimeve në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar (këtu e në vijim LPP). Synimi i ndryshimeve dhe shtesave të paraqitura përmes këtij projektligji është përpara së gjithash rritja e mëtejshme e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik dhe nxitja e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë vendas e të huaj në procedurat e prokurimit publik, në funksion të mirëmenaxhimit të fondeve publike.

Ky ligj, përpara miratimit të tij, ka qënë objekt i konsultimeve të ndryshme me ministritë e linjës dhe autoritetet kontraktore më të mëdha në vend, si dhe është dërguar për komente pranë SIGMA-s, qëndrimet e të cilëve u morën në konsideratë dhe u reflektuan në dispozitat përkatëse. Ndryshimet e LPP u miratuan me Ligjin Nr. 182/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar”.

Disa prej ndryshimeve të këtij ligji konsistojnë në përafrimin e plotë të disa prej dispozitave të tij me parashikimet përkatëse të direktivave të Bashkimit Evropian (BE). Konkretisht, me ligjin e sipërcituar janë shtuar si rast përjashtimor nga dispozitat e ligjit për prokurimin publik, kontratat e punësimit. Kjo shtesë vjen në përputhje edhe me Direktivën e re 2014/24 të BE, e cila parashikon gjithashtu këtë rast përjashtimor.

Në përputhje të plotë me frymën e direktivave të BE vjen edhe rregullimi në lidhje me sigurimin e ofertës, e cili është lënë si mundësi për t’u paraqitur nga operatorët ekonomikë, vetëm në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e lartë monetar.

Sigurimi i ofertës nuk parashikohet si koncept, si në Direktivën 2004/18/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 31 Mars 2004, për koordinimin e procedurave të prokurimit për shpalljen fituese të kontratave publike për punë, furnizime dhe shërbime, ashtu edhe në Direktivën e re 2014/24/EU e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 26 Shkurt 2014, për prokurimin publik dhe që shfuqizon Direktivën 2004/18/EC.

Në ligjin e prokurimit publik të sipërcituar parashikohen edhe shtesa dhe ndryshime të tjera, të cilat kanë për qëllim të saktësojnë dispozitat aktuale të tij dhe të shmangin rastet e keqinterpretimit të këtyre dispozitave nga autoritetet kontraktore, në kuadër të rritjes së efikasitetit të procedurave të prokurimit.

3.2. Iniciativat nënligjore të APP-së

3.2.1 Prokurimi publik

➤ Vendime të Këshillit të Ministrave

Në kuadër të ndryshimeve të sipërpërmendura në ligjin e prokurimit publik, gjatë katëmuorit të fundit të vitit 2014 APP përgatiti dhe ndryshimet përkatëse në rregullat e prokurimit publik, të cilat u miratuan me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Si ndryshime kryesore të këtij vendimi mund të përmendim, ndryshimet në mënyrën e kryerjes së Marrëveshjes Kuadër, me qëllim reflektimin e problematikave të ngritura nga Autoritetet Kontraktore si dhe rritjen e kufirit monetar për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, nga 400 000 në 800 000, ndryshim ky i cili synon lehtësimin e punës së autoriteteve kontraktore.

Në këtë mënyrë, Vendimi i mëparshëm Nr. 1, datë 10.01.2007, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe të gjitha udhëzimet e dala në zbatim të tij u shfuqizuan.

Përveç ndryshimeve, të cilat kanë ardhur si rezultat i reflektimit të ndryshimeve ligjore, qëllimi tjetër i përgatitjes dhe miratimit të një vendimi të ri për rregullat e prokurimit publik ishte riorganizimi i dokumentit të mëparshëm, si dhe parashikimi në mënyrë më të qartë dhe kronologjike i hapave proceduriale që ndiqen në procesin e prokurimit.

- Në muajin Dhjetor 2014, APP përgatiti dhe projekt vendimin “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”, i cili u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 918, datë 29.12.2014, “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”.

Ky vendim ripërcakton detyrimin për kryerjen elektronikisht të procedurave të prokurimit publik, duke shprehur qartë përjashtimin nga zhvillimi elektronikisht, për procedurat e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, fazën e dytë të procedurave të prokurimit shërbim konsulence dhe konkurs projektimi, procedurat e prokurimit për blerjen e energjisë elektrike. Ky përjashtim u bë për shkak të specifikës së këtyre lloj procedurave.

Po në përputhje me këtë vendim, procedurat e prokurimit me vlerë të vogël nën 100,000 lekë dhe ato që zhvillohen në raste emergjentë do të kryhen në formë shkresore.

➤ Udhëzime dhe Vendime të APP

Gjatë vitit 2014, për t'i ardhur në ndihmë autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë, APP-ja ka hartuar Udhëzimet si më poshtë:

- Udhëzimin Nr. 1, datë 28.02.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr.2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, ndryshuar me Udhëzimin nr.5, datë 16.07.2013”.

Ky udhëzim u konsiderua i nevojshëm nga problematika e konstatuar në praktikë në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël.

Nëpërmjet këtij udhëzimi iu dha zgjidhje rasteve të tërheqjes nga gara të ofertuesve, sipas renditjes së tyre deri në ofertuesin e fundit të mbetur në garë, si dhe situatave të krijuara në rastet e dështimit dy herë radhazi të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve edhe në rastet kur ka pasur konkurrencë.

Gjithashtu, ky udhëzim ka orientuar në pengimin e ofertimit të papërgjegjshëm nga operatorët ekonomikë, të cilët në mënyrë të pajustificuar nuk njoftojnë dhe nuk paraqiten për realizimin e objektit të prokurimit, duke shtuar detyrimin e këtyre ofertuesve për të njoftuar autoritetet kontraktore në rast të pamundësisë së realizimit të objektit të prokurimit.

Nëse kjo gjë nuk bëhet nga operatorët ekonomikë, APP ka udhëzuar autoritetet kontraktore që të mund të refuzojnë ofertën e paraqitur nga një operator ekonomik në një procedurë prokurimi i cili, në procedura të mëparshme prokurimi me vlerë të vogël, të zhvilluara nga ky autoritet, nuk e ka njoftuar brenda afatit kohor të përcaktuar, mbi arsyet, që kanë çuar në pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit

- Udhëzimin Nr. 02, datë 03.05.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 3, datë 01.06.2010 të Agjencisë së Prokurimit Publik”.

Nisur nga problematika e konstatuar në praktikë, ku procedurat e prokurimit mbeten të paarkivuara në sistemin e prokurimit elektronik, nëpërmjet këtij udhëzimi, autoritetet kontraktore janë orientuar që bëjnë arkivimin e këtyre procedurave brenda një dite pune nga mbyllja e fazës së njoftimit të kontratës së lidhur.

- Në funksion të zgjidhjes së kësaj problematike, APP ka nxjerrë edhe Udhëzimin Nr. 3, datë 03.04.2014 “Për një shtesë në Udhëzimin Nr. 4, datë 04.07.2013 të Agjencisë së Prokurimit Publik “Për zhvillimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë”.

Ku udhëzim ka orientuar autoritetet kontraktore që bëjnë arkivimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël brenda një dite pune nga mbyllja e fazës së njoftimit të fituesit.

- Në vitin 2014, APP nëpërmjet Vendimit Nr. 1, datë 21.01.2014 “Për miratimin e një shtese dhe ndryshimi në Dokumentat Standarde të Tenderit për furnizimin e mallrave, shërbimeve dhe kryerjen e punëve” ka miratuar një ndryshim në këto dokumenta, lidhur me Kriteret e Përgjithshme të Pranimit të përcaktuara në Shtojcën “Kriteret e Pranimit”.

Nga komunikimet shkresore të APP me Qendrën Kombëtare të Regjistrimit u konstatua ndryshimi i formatit të Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar për të Dhënat e Subjektit, të lëshuar nga ky institucion, në funksion të detyrave të ngarkuara në kuadër të legjislacionit përkatës.

Në këtë dokument, të riformatuar, nuk do të pasqyrohet gjendja gjyqësore e subjekteve, konkretisht, se nuk është dënuar për shkelje penale dhe nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional.

Duke qenë se referuar dispozitave ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik, këto dy pika lidhen drejtpërdrejt me kualifikimin e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit, për të shmangur çdo paqartësi të palëve të përfshira në procesin e prokurimit dhe për t'iu përshtatur kërkesave të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në funksion të përmbushjes së detyrimeve ligjore të këtij institucioni, u bë ndryshimi i Shtojcës së Kriterëve të Pranimit.

Nëpërmjet këtij ndryshimi, kërkesat mbi gjendjen gjyqësore të subjektit plotësohen me dorëzimin e Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, si dhe vetëdeklarimin e subjektit, sipas Shtojcës “Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore”, të hartuar nga APP, e cila u bë pjesë e setit të Dokumentave Standarde të Tenderit.

- Gjithashtu, një ndryshim tjetër në Dokumentat Standarde të Tenderit është miratuar me Vendimin Nr. 9, datë 22.09.2014 të APP.

Nëpërmjet këtij vendimi, në zbatim të nenit 21 të ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, është ndryshuar formulari i deklaratës mbi konfliktin e interesave, pjesë e Dokumentave Standarde të Tenderit, duke shtuar në kategorinë e zyrtarëve që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik, edhe Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit.

Ndalimi për përfitime nga kontratat me një institucion publik është shtuar edhe për bashkëjetuesit dhe prindërit e bashkëjetuesit të kategorisë së zyrtarëve të përcaktuar në ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

3.2.2 Koncesionet dhe partneriteti publik privat

Në drejtim të legjislacionit të koncesioneve dhe partneritetit publik privat, në muajin Shkurt 2014 APP përgatiti dhe dërgoi për miratim projekt vendimin për kryerjen në mënyrë elektronike të procedurave konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, i cili u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 130, datë 12.03.2014 “Për kryerjen në mënyrë elektronike të procedurave konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat”.

Ky Vendim u miratua si rezultat i ligjit të ri 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i cili për herë të parë parashikonte dhe rregullonte procedurat e partneritetit publik privat. Ndodhur në kushtet kur vendimi Nr. 268, datë 18.04.2012 “Për kryerjen në mënyrë elektronike të procedurave konkurruese të dhënies së koncesionit” kishte dalë në bazë të ligjit Nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, i cili dhe ishte shfuqizuar, rregullonte vetëm kryerjen e procedurave koncesionare në mënyrë elektronike, lindi nevoja e një Vendimi të ri, i cili duhet të parashikonte kryerjen në formë elektronike të publikimit të njoftimit të kontratës

dhe dokumentave përkatës për procedurat konkurruese të dhënies së konçesionit dhe partneritetit publik privat si dhe ofertimit në mënyrë elektronike nga ana e operatorëve ekonomikë të interesuar.

Publikimi në formë elektronike i gjithë dokumentacionit të një procedure koncesioni dhe partneriteti publik privat, synon të rrisë në maksimum transparencën dhe t'i japë akses të plotë dhe falas në dokumentacion, çdo operatori ekonomik të interesuar për të marrë pjesë në këto procedura konkurruese.

3.3. Iniciativat nënligjore në proces

Me miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore të sipërpërmendura, në fund të vitit 2014, APP intensifikoi punën për hartimin e akteve nënligjore dhe udhëzimeve të ndryshme, me qëllim reflektimin e ndryshimeve të bëra në këtë drejtim.

4. SFIDAT DHE ARRITJET KRYESORE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK GJATË VITIT 2014

Sfidat kryesore me të cilat është përballur APP, gjatë vitit 2014, kanë konsistuar kryesisht në ndryshimin e kuadrit legjislativ të prokurimeve publike, me qëllim përmirësimin dhe rritjen e efikasitetit të sistemit të prokurimit publik, në monitorimin e procedurave të prokurimit publik, në menaxhimin e sistemit të prokurimit elektronik si dhe rritjen e kapaciteteve të këtij sistemi, në kushtet kur të gjitha procedurat e prokurimit publik që kërkojnë njoftim paraprak, përfshirë dhe procedurat e prokurimit me vlerë të vogël zhvillohen me mjete elektronike, si dhe në ngritje e kapaciteteve administrative të punonjësve të ngarkuar me kryerjen e procedurave të prokurimit publik në vend.

Përmirësimi i legjislacionit në këtë fushë, për të cilin APP është angazhuar maksimalisht, përveçse një detyrë ligjore e kësaj të fundit, është njëkohësisht edhe një detyrë që vjen nga detyrimet e marra përsipër në kuadër të procesit të integritetit dhe më konkretisht të përafrimit të legjislacionit të brendshëm me Direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian.

Në këtë kuadër, APP luajti një rol të rëndësishëm në grupin ndërinstitutional të punës, të ngritur për përgatitjen e ndryshimeve të LPP, si në adresimin e problematikave të dala në praktikë nga zbatimi i legjislacionit të prokurimit publik, ashtu edhe në përafrimin e këtyre ndryshimeve me Direktivat përkatëse të BE-së.

Gjithashtu, me qëllim reflektimin e ndryshimeve ligjore, si dhe me qëllim saktësimin e disa çështjeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave që miratonte rregullat e prokurimit publik, APP mori iniciativën e hartimit të një drafti të ri të rregullave të prokurimit publik, ku jo vetëm u reflektuan ndryshimet ligjore, por u riorganizua i gjithë dokumenti i mëparshëm, si dhe u parashikuan në mënyrë më të qartë dhe kronologjike të gjithë hapat proceduriale që ndiqen në procesin e prokurimit. Me përfundimin e këtyre dy akteve ligjore dhe nënligjore, në fund të vitit 2014, një sfidë për APP ishte përgatitja e të gjitha akteve të tjera nënligjore, përfshirë dhe Dokumentet Standarde të Tenderit, me qëllim miratimin e paketës së plotë rregulluese brenda muajit Janar 2015, për të mos penguar veprimtarinë e autoriteteve kontraktore.

Një tjetër sfidë me të cilën është përballur APP gjatë vitit 2014, ka qënë monitorimi i procedurave të prokurimit publik të kryera nga autoritete të ndryshme kontraktore, me fokus të veçantë procedurat me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit. Qëllimi i procesit të monitorimit ka qënë evidentimi i shkeljeve procedurale si në përzgjedhjen e procedurës së prokurimit, ashtu dhe në fazën e përgatitjes dhe vlerësimit të procedurës konkrete. Me vendimet e marra në përfundim të procedurave monitoruese, APP ka synuar jo vetëm marrjen e masave ndëshkuese për personat përgjegjës që kanë shkelur legjislacionin e prokurimit publik, por edhe udhëzimin e autoriteteve kontraktore për mos përsëritjen e shkeljeve në të ardhmen. APP e ka kryer me përgjegjësi dhe seriozitet këtë detyrë (edhe pse me një numër të kufizuar punonjësish të angazhuar për këtë qëllim) pasi beson se monitorimi i zbatueshmërisë së ligjit, është një mekanizëm shumë i mirë për rritjen e përgjegjshmërisë në Autoritete Kontraktore dhe rrjedhimisht dhe për rritjen e efikasitetin të sistemit të prokurimit publik në përgjithësi. Të dhëna më të detajuara mbi procesin e monitorimit, do të jepen në vijim të kësaj analize.

Gjatë vitit 2014, një sfidë për APP ka qënë dhe përfaqësimi në çështje gjyësore, ku ka qënë palë, kjo sidomos për shkak të numrit të reduktuar të stafit në dispozicion për këtë qëllim. Duke qënë se gjatë këtij viti, në ndryshim nga gjithë vitet e tjera, për shkak të ushtrimit të kompetencës së monitorimit, numri i vendimeve të marra nga APP ishte i konsiderueshëm, edhe numri i çështjeve në gjykatë është rritur ndjeshëm, krahasuar me vitet e mëparshme.

Në lidhje me procesin e vazhdueshëm të përmirësimit të prokurimit elektronik, APP, gjatë këtij viti ka punuar intensivisht për ngritjen e kapaciteteve të sistemit si në pjesën operacionale ashtu dhe në atë të arkivës. Sfidë më e madhe e APP-së në këtë drejtim ka qënë menaxhimi i ngarkesës së sistemit për shkak të numrit shumë të lartë të procedurave të zhvilluara në të, numër i cili rritet ndjeshëm për shkak të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Një tjetër sfidë gjatë këtij viti ka qënë edhe hartimi i udhëzimeve përkatëse, për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë, në lidhje me çdo funksionalitet të ri të krijuar në sistem sidomos për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël si dhe trajnimi i Autoriteteve Kontraktore mbi zbatimin e legjislacionit të prokurimit publik, në kushtet kur numri i kërkesave për këto trajnime, ka qënë shumë i lartë.

5. BASHKËPUNIMI I AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK ME INSTITUCIONE HOMOLOGE VENDASE DHE TË HUAJA, TË VENDEVE ANËTARE TË BE-SË DHE INSTITUCIONE TË TJERA NDËRKOMBËTARE.

5.1. Bashkëpunimi i APP-së me institucione homologe të vendeve të rajonit dhe të BE-së

Gjatë vitit 2014, APP ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë me institucione homologe ndërkombëtare. Në këtë kuadër përfaqësues nga APP kanë marrë pjesë në takime ndërkombëtare, kanë zhvilluar vizita në disa nga vendet e rajonit dhe të BE-së, si dhe kanë pritur delegacione me përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare.

Sikurse e kemi përmendur më sipër, një bashkëpunim shumë të rëndësishëm gjatë këtij viti APP-ja ka vazhduar të ketë me SIGMA-n, një iniciativë e përbashkët e OECD dhe Bashkimit Evropian, financuar nga BE, me të cilën ka punuar ngushtësisht për hartimin e Strategjisë mbi Sistemin e Prokurimit Publik në Shqipëri dhe draft ndryshimet në legjislacionin e prokurimit publik, bashkëpunim ky që u finalizua me sukses, duke pasur si produkt Strategjinë mbi prokurimin publik, si pjesë të Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020, si dhe dy aktet ligjore dhe nënligjore të sipërpërmendura, të miratuara në muajin Dhjetor 2014.

Gjatë këtij viti APP ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë dhe me përfaqësinë e Bankës Botërore në Shqipëri. Përveç pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme, të organizuara nga kjo e fundit, në vitin 2014 APP me propozim të Bankës Botërore, ka aplikuar dhe për një projekt ku kërkohet asistencë e kësaj të fundit për përcaktimin e treguesve për matjen e performancës në sistemin e prokurimit publik dhe përf forcimin e transparencës së sistemit të prokurimit elektronik.

5.2. Bashkëpunimi i APP-së me institucione të tjera në Shqipëri

E dhe gjatë vitit 2014, APP ka patur një bashkëpunim të ngushtë me institucione të pushtetit qendror dhe vendor brenda vendit. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, nga APP-ja janë dhënë sqarime dhe këshilla për këto institucione, sipas kërkesave, me qëllim zbatimin sa më korrekt të legjislacionit të prokurimit publik, legjislacionit të koncesioneve dhe partneritetit publik privat dhe atij të ankandit publik.

Një bashkëpunim të ngushtë dhe intensiv, APP-ja ka vazhduar të ketë dhe gjatë vitit 2014, me Ministrinë e Integritimit. Në mënyrë periodike, në Ministrinë e Integritimit është raportuar progresi i APP-së në drejtim të zbatimit të angazhimeve që janë marrë me nënshkrimin e MSA-së në fushën e prokurimeve publike. Me këtë Ministri janë realizuar takime të shpeshta që kanë pasur si objektiv konsultimin e specialistëve me qëllim realizimin e objektivave në kuadër të integritetit.

Bashkëpunim shumë të mirë dhe të suksesshëm gjatë vitit 2013 APP-ja ka pasur dhe me Shkollën e Administratës Publike (ASP), në bashkëpunim me të cilin ka realizuar disa trajnime për Autoritetet Kontraktore me qëllim njohjen e tyre me kuadrin ligjor dhe përmirësimet e sistemit të prokurimit elektronik.

Një tjetër bashkëpunim intensiv gjatë vitit 2014, APP-ja ka pasur me institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, me qëllim evidentimin dhe penalizimin e shkeljeve të konstatuara gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit nga autoritete të ndryshme kontraktore.

Gjatë vitit 2014, APP-ja në ushtrimin e detyrave të saj ligjore, ka pasur bashkëpunim edhe me institucionin e Komisionit të Prokurimit Publik. Në bazë të dispozitave të legjislacionit të prokurimit publik, KPP-ja ka njoftuar APP-në në rastet e marrjes së vendimeve për pezullimin e procedurave të prokurimit, me qëllim që ky vendim të pasqyrohet në sistemin e prokurimit elektronik për mosprocedimin e mëtejshëm nga ana e autoriteteve kontraktore. Gjithashtu, ky

bashkëpunim evidentohet edhe në rastin e pasqyrimin në sistemin e prokurimit elektronik të vendimeve të dhëna nga KPP-ja, në përfundim të shqyrtimit të ankesave.

Të dy institucionet kanë bashkëpunuar edhe në kuadër të raportimeve në Ministrinë e Integritetit mbi detyrimet në këtë drejtim në fushën e prokurimit publik, në të gjitha ato raste ku raportimet janë kërkuar në nivel të Kapitullit 5 “Prokurimi Publik”.

6. TREGUESIT E VEPRIMTARISË SË DREJTORIVE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK, GJATË VITIT 2014

6.1. TREGUESIT TË VEPRIMTARISË SË DREJTORISË JURIDIKE, MONITORIMIT DHE PUBLIKIMIT

V eprimtaria e Drejtorisë Juridike, Monitorimit dhe Publikimit, gjatë kësaj periudhe është fokusuar kryesisht në hartimin e projektakteve ligjore dhe nënligjore dhe udhëzimeve për unifikimin e praktikave në fushën e prokurimit publik, në monitorimin e procedurave të prokurimit sipas planit të brendshëm të APP, në shqyrtimin e raporteve të auditimit të dërguara nga organe të ndryshme audituese, në dhënien e mendimeve, këshillave apo udhëzimeve në ndihmë të autoriteteve kontraktore, dhënien e mendimeve për projektvendime të ndryshme, shqyrtimin e propozimeve për përjashtimin nga e drejta për të marrë pjesë në procedurat e prokurimeve publike apo procedurat e ankandeve, të shoqërive të ndryshme, si dhe në trajnimin e përfaqësuesve të Autoriteteve Kontraktore.

Më konkretisht, gjatë vitit 2014 Drejtoria Juridike, Monitorimit dhe Publikimit e përqëndroi veprimtarinë e saj në këto drejtime kryesore:

6.1.1. Ndryshimet në kuadrin ligjor

D rejtoria Juridike, Monitorimit dhe Publikimit, gjatë vitit 2014, ka dhënë një kontribut shumë të rëndësishëm për përmirësimin e legjislacionit të prokurimit publik, legjislacionit të koncesioneve dhe PPP-ve, si dhe për nxjerrjen e një sërë udhëzimesh për t’u ardhur në ndihmë autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë.

Kjo drejtori ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në hartimin e disa ndryshimeve në LPP dhe në përgatitjen e draftit të rregullave të prokurimit publik, akteve të tjera dytësore në këtë drejtim, Dokumentat Standarde të Tenderit, si dhe gjithë udhëzimet e APP të përgatitura në zbatim të legjislacionit të prokurimit publik në fuqi.

6.1.2. Praktikë e shqyrtuara për dhënie mendimesh, këshilla apo udhëzimesh

G jatë këtij viti, Drejtoria Juridike, Monitorimit dhe Publikimit, në zbatim të detyrave që i ngarkojnë legjislacionet respektive në fushën e prokurimit publik, koncesioneve/ppp dhe ankandit publik, ka shqyrtuar një numër të konsiderueshëm praktikash, të cilat kanë pasur të bëjnë me dhënien e mendimeve, këshillave apo udhëzimeve në ndihmë të autoriteteve kontraktore, dhënien e mendimeve për projektvendime të ndryshme, udhëzime për unifikimin e praktikave, shqyrtimin e propozimeve të autoriteteve kontraktore për përjashtimin të shoqërive të ndryshme, shqyrtimin e praktikave të auditimit, të përcjella nga institucionet audituese dhe monitorimin e procedurave të prokurimit.

Më konkretisht, të dhënat në lidhje me ushtrimin e këtyre kompetencave, paraqiten më poshtë.

Asistenca e kësaj drejtorie, ndër të tjera, është përqendruar në mirëmbatimin e rregullave të prokurimit dhe këshillimin ligjor për problemet e ndeshura gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit publik nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik.

Një numër i konsiderueshëm kërkesah për mendime janë fokusuar në mënyrën e procedimit në rastin e aplikimit të Marrëveshjes Kuadër, si dhe problematikat e ndryshme të vërejtura në prokurimet me vlerë të vogël, të cilat që prej vitit 2013 realizohen nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike.

Gjatë vitit kalendarik, kjo drejtori ka patur edhe kontakte shkresore me institucione të ndryshme si; Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore në lidhje me informacione të ndryshme të kërkuara nga ana e tyre mbi procedurat e prokurimit, me institucionin e Avokatit të Shtetit mbi proceset gjyqësore që perfaqësojnë APP-në në cilësinë e palës së paditur apo operatorë të ndryshëm ekonomikë.

Konkretisht, numri total i praktikave të paraqitura në këtë drejtori për **mendim, sqarim apo informacione nga institucione të ndryshme**, për çështje që lidhen me procesin e prokurimit publik, koncesioneve/ppp-ve, dhe ankandeve gjatë vitit 2014 është rreth **250**.

Gjithashtu, gjatë këtij viti, kjo drejtori ka dhënë mendime dhe për projektvendime të ndryshme të iniciuara nga institucione të tjera, të cilat i janë përcjellë për mendim APP-së.

Numri total i praktikave, për të cilat, kjo drejtori ka dhënë **mendime për projektvendime të ndryshme**, gjatë vitit 2014 është **12**.

6.1.3. Gjjobat dhe masat disiplinore

A. Monitorimi i procedurave të prokurimit sipas planit të APP-së

Një ndër detyrat kryesore të kësaj Drejtorie gjatë vitit 2014, ka qënë verifikimi i zbatimit të procedurave të prokurimit publik, pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit.

Në funksion të përmbushjes së këtij detyrimi ligjor, Drejtoria ka hartuar dy Plane Monitorimi, duke përzgjedhur si objekt monitorimi procedura prokurimi të zhvilluara nga autoritete të ndryshme kontraktore, gjatë vitit 2014.

Si kriter për përzgjedhjen e procedurave të prokurimit, objekt monitorimi, kryesisht është marrë në konsideratë Lloji i Procedurës së Prokurimit, konkretisht, “Procedura e Prokurimit Negociim pa Shpallje Paraprake të Njoftimit të Kontratës”, si një procedurë e veçantë prokurimi, që përdoret në rrethana të caktuara, të parashikuara në dispozitat ligjore të prokurimit publik.

Duke qënë se, procedura e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës është një procedurë, që nuk kërkon publikim, pra nuk lejon pjesëmarrje të gjerë të operatorëve ekonomikë, përdorimi i saj nga autoritetet kontraktore mund të bëhet abuziv dhe të çojë në shmangien e konkurrencës ose në diskriminim të operatorëve ekonomikë.

Gjithashtu, në përzgjedhjen e procedurave konkrete të prokurimit për monitorim është marrë

për bazë vlera e fondit limit, natyra e objektit të prokurimit, fakti që oferta fituese është afër ose e barabartë me fondin limit të procedurës, si dhe ankimimet e operatorëve ekonomikë të ndryshëm.

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2014 janë monitoruar në **Total 82 procedura prokurimi**, të zhvilluara nga **52 Autoritete Kontraktore**. Në përfundim të procesit të monitorimit, në rastin e konstatimit të shkeljeve të legjislacionit të prokurimit publik në fuqi, APP në varësi të kohës së kryerjes së procedurës së prokurimit (duke pasur në konsideratë rregullimin ligjor në kohën e kryerje së procedurës), llojit të shkeljes, fondit limit në dispozicion të procedurës së prokurimit, si dhe pasojës së ardhur, ka marrë vendim për dënim me gjobë, ose propozim për marrjen e masës disiplinore, ndaj personave përgjegjës.

Llojet e procedurave të prokurimit të monitoruara janë si më poshtë:

Lloji i Procedurës së Prokurimit	Numri i Procedurave të Monitoruara
Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit	62
Procedurë e hapur	13
Kërkesë për propozim	3
Procedura prokurimi me vlerë të vogël	4

Në këto procedura të monitoruara janë marrë **masat e mëposhtme**:

GJOBA

Roli i zyrtarit	Numri
Titullar i Autoritetit Kontraktor	17 Autoritete Kontraktore
Anëtar i Njesisë së Prokurimit	23 Autoritete Kontraktore
Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave	27 Autoritete Kontraktore
Anëtar i Grupit për Përllogaritjen e Fondit Limit	13 Autoritete Kontraktore

MASA DISIPLINORE TË PROPOZUARA

Roli i zyrtarit	Numri
Titullar i Autoritetit Kontraktor	1 Autoritet Kontraktor
Anëtar i Njesisë së Prokurimit	26 Autoritete Kontraktore
Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave	7 Autoritete Kontraktore
Anëtar i Grupit për Përlogaritjen e Fondit Limit	4 Autoritete Kontraktore
Anëtar i Komisionit të Prokurimeve me Vlerë të Vogël	3 Autoritete Kontraktore

Sikurse shihet qartë nga të dhënat e pasqyruara në tabelën e mësipërme, lloji i procedurës së prokurimit që është monitoruar më shumë, është procedura me negociim pa shpallje paraprake.

Synimi i monitorimit të kësaj lloj procedure, ka qënë identifikimi i arsyeve që çojnë një autoritet kontraktor në përzgjedhjen e kësaj lloj procedure (duke qënë se zhvillimi i saj nuk bëhet në mënyrë transparente dhe konkurese), kontrolli i përmbushjes dhe zbatueshmërisë së kushteve të parashikuara nga legjislacioni i prokurimit publik për këtë rast si dhe parandalimin e përzgjedhjes së gabuar të kësaj lloj procedure në të ardhmen.

Gjetja kryesore e APP-së në monitorimin e kësaj lloj procedure, është që në shumicën e rasteve Autoritetet Kontraktore **nuk justifikojnë rrethanat e papaparashikuara** që i çojnë ato në pamundësi për të planifikuar në kohë nevojat e tyre, me qëllim përmbushjen e këtyre të fundit nëpërmjet procedurave konkurese, sipas parashikimeve ligjore për përzgjedhjen e kësaj lloj procedure.

Në këtë rast, kur AK ka pasur mundësi të parashikojë në kohë nevojën, por me mosveprimet e tij, ka sjellë “krijimin e një situate emergjente”, përzgjedhja e procedurës së prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, është konsideruar në shkelje të dispozitave ligjore dhe nënligjore për prokurimin publik, në fuqi.

Përveç përzgjedhjes së gabuar të kësaj lloj procedure, sikurse kemi analizuar më sipër, një tjetër shkelje e konstatuar nga APP, ka qënë lidhja e kontratave afatgjate, ndërkohë që legjislacioni në fuqi, përcakton në mënyrë të qartë mundësinë e përdorimit të kësaj procedure, vetëm për të zgjidhur situatat emergjente, duke ndaluar shprehimisht lidhjen e kontratave afatgjate. Zyrtatët e gjetur fajtor për këtë lloj shkelje janë dënuar individualisht, kryesisht me gjobë që varion nga 500,000 në 1,000,000 lekë, si një nga masat administrative të parashikuara nga LPP, për këtë rast.

B. Shqyrtimi i raporteve audituese

- Raporte audituese për procedura prokurimi

V eprimtaria e Drejtorisë gjatë vitit 2014 është fokusuar edhe në shqyrtimin e rekomandimeve të institucioneve audituese, për marrje masash në rast shkeljesh të konstatuara në procedura të ndryshme prokurimi.

Në përfundim të shqyrtimit të këtyre raporteve, si dhe nga hetimet administrative të kryera pas ankimeve të operatorëve të ndryshëm, janë vendosur gjoba, si dhe janë propozuar masa disiplinore ndaj personave përgjegjës, si më poshtë:

GJOBA

Nga Hetimi administrativ i APP (inicuar nga të tretët)	Nga auditimet e KLSH	Nga Auditet Brendshme të Autoriteteve	Nga vendimet e KPP
3 Autoriteteve Kontraktore	8 Autoriteteve Kontraktore	12 Autoriteteve Kontraktore	3 Autoriteteve Kontraktore

MASA DISIPLINORE TË PROPOZUARA

Nga Hetimi administrativ i APP	Nga auditimet e KLSH	Nga Auditet Brendshme të Autoriteteve	Nga vendimet e KPP
4 Autoriteteve Kontraktore	13 Autoriteteve Kontraktore	17 Autoriteteve Kontraktore	15 Autoriteteve Kontraktore

- Raporte audituese për procedura koncesioni

Në bazë të kompetencave ligjore të APP, është shqyrtuar rekomandimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit, si institucion auditues, për marrje masash në rastin e shkeljeve të konstatuara në një procedurë të dhënies me konçesion.

Në përfundim të shqyrtimit të raportit përfundimtar dhe dokumentacionit shoqërues të dërguara nga KLSH, APP, në ushtrim të detyrave të saj, ka vendosur gjoba, si dhe janë propozuar masa ndëshkuese ndaj personave përgjegjës.

GJOBA DHE MASA DISIPLINORE TË PROPOZUARA

Nga auditimet e KLSH	
1 Autoritet Kontraktor	
Masa Disiplinore	Gjoba
3 persona	18 persona

6.1.4. Shqyrtimi i propozimeve për përjashtimin e operatorëve ekonomikë

Një kompetencë tjetër ligjore e APP, që është ushtruar nëpërmjet kësaj drejtorie gjatë vitit 2014, ka qenë dhe marrja në shqyrtim e propozimeve të autoriteteve kontraktore/operatorëve ekonomikë, për përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga e drejta për të ofertuar në procedura prokurimi apo procedura ankandi për një periudhë të caktuar kohore.

Konkretisht, gjatë vitit 2014 u morën në shqyrtim **35 propozime për përjashtimin e operatorëve ekonomikë**, nga të cilat u fillua procedimi administrativ për përjashtimin nga procedurat e prokurimit për **12** operatorë ekonomikë.

Në përfundim të procedimit administrativ, është marrë vendim për përjashtim nga e drejta për të marrë pjesë në prokurime, për **6 (gjashtë)** operatorë ekonomikë. Nga këta:

5 (pesë) Operatorë Ekonomikë janë përjashtuar për shkak të keqinformimit, nëpërmjet paraqitjes në tender të dokumentave, që përmbajnë të dhëna të rreme, sipas përcaktimeve të nenit 13/3/a të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

1 (një) Operator Ekonomik është përjashtuar për shkak të mospërbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas përcaktimeve të nenit 13/3/ç të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ndërkohë, 1 (një) Operator Ekonomik, është përjashtuar me vendim plotësues të institucionit të Prokurorisë, për konstatim të paraqitjes së të dhënave të rreme në dokumentat e tenderit, vendim i cili është dërguar në APP për ta pasqyruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Për 2 (dy) operatorë ekonomikë është marrë vendim mos përjashtimi, pasi është arritur në përfundimin se nuk plotësohen kushtet e nenit 13 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Për 3 operatorë ekonomikë, APP ka pezulluar procedimin administrativ për shkak të procesit gjyqësor.

Për 1 (një) operator ekonomik, procedimi është ende në proces.

Për 23 kërkesa me të cilat propozohet përjashtimi i operatorëve ekonomikë, kërkesa e paraqitur është konsideruar me dokumentacion të pamjaftueshëm dhe e paargumentuar për

fillimin e procedimit administrativ, dhe iu është kërkuar propozuesve të plotësojnë kërkesat.

Në formë tabelore të dhënat e mësipërme paraqiten si më poshtë:

TOTALI				
36 kërkesa për përjashtim				
Vendime përjashtimi	Vendime mos përjashtimi	Procedime administrative të pezulluara	Procedime administrative në proces	Kërkesa të paplota
6 (+1 me vendim plotësues prokurorie)	2	3	1	23

4 nga vendimet e APP për përjashtim, janë ankimuar nga pala e prekur nga vendimi, në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative, Tiranë, nga të cilat për 1 është pranuar kërkesë padia, për dy është rrëzuar kërkesë padia dhe një është ende në proces. Informacion më i detajuar në këtë drejtim jepet në seksionin më poshtë.

6.1.5. Përfaqësimi në proceset gjyqësore

Gjatë vitit 2014, APP është përfaqësuar në proceset gjyqësore si palë e paditur kryesisht nga operatorë ekonomikë të përjashtuar nga pjesëmarrja në prokurimet publike apo zyrtarët e AK-ve të dënuar me gjobë në përfundim të procesit të monitorimit. Sikurse është cilësuar dhe në fillim të kësaj analize vjetore, përfaqësimi në gjykatë për të mbrojtur vendimet e APP-së, ka qënë një sfidë, për shkak të numrit shumë të lartë të çështjeve gjyqësore ku APP ka qënë e thirrur si palë ndërgjyqëse.

Gjithsej në vitin 2014, nga APP janë ndjekur **106 çështje gjyqësore**, nga të cilat **74 çështje** në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë dhe **32 çështje** në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.

Nga **74 çështjet** gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, janë përfunduar **68 çështje** dhe janë në proces **6** prej tyre.

Nga **74 çështjet** gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë,

- **5 çështje janë kundër vendimeve të APP-së përjashtimin e operatorëve ekonomikë,**
- **67 çështje janë për vendime të APP për dënime me gjobë, në përfundim të procesit të monitorimit, dhe**
- **2 çështje janë për marrëdhënie pune.**

Nga **5 çështjet** gjyqësore kundër vendimeve të APP për përjashtimin e operatorëve ekonomikë,

- **për 1 çështje është pranuar kërkesë padia,**
- **për 2 çështje është rrëzuar kërkesë padia,**
- **1 çështje është pushuar, dhe**
- **1 çështje është ende në proces.**

Nga **67 çështjet** gjyqësore kundër vendimeve të APP për dënime me gjobë, në përfundim të procesit të monitorimit, **62 çështje kanë përfunduar në shkallë të parë**, dhe konkretisht Gjykata ka vendosur:

- në 24 çështje pranimin e kërkesë padisë;
- në 34 çështje rrëzimin e kërkesë padisë;
- në 2 çështje pranimin pjesërisht të kërkesë padisë;
- në 2 çështje është vendosur pushimi,

Ndërkohë, 5 çështje janë ende në proces.

Për 2 çështjet gjyqësore kundër APP, me objekt marrëdhëniet e punës, Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë ka dhënë vendimin përfundimtar duke vendosur,

- për një çështje pranimin e kërkesë padisë dhe
- për çështjen tjetër pranimin pjesërisht të kërkesë padisë.

Nga **68** vendimet gjyqësore për çështjet e përfunduara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, **32 vendime janë apeluar në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë**, nga të cilat,

- 19 vendime janë apeluar nga APP dhe
- 13 vendime janë apeluar nga pala tjetër ndërgjyqëse.

Nga 32 çështjet e apeluara në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë,

- janë përfunduar me vendim të formës së prerë 2 çështje, dhe
- janë ende në proces 30 çështje.

Përveç çështjeve gjyqësore pranë gjykatave administrative, sikurse analizuar më sipër, APP është palë në **1 çështje** në Gjykatën e Lartë, e cila është ende në proces.

Në rastin e fletëthirrjeve për t'u paraqitur si palë ndërgjyqëse në gjykatat administrative në rrethe, APP iu është drejtuar këtyre të fundit me kërkesë për shpalljen e moskompetencës, sipas ligjit 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

6.1.6. Veprimtaria e Drejtorisë në drejtim të publikimit

Në Buletinin e Njoftimeve Publike (këtu e në vijim Buletini) janë botuar njoftime kontratash për procedurat e shpallura të prokurimit, njoftimet e fituesit, njoftimet e kontratave të nënshkruara, njoftimet e anullimit të procedurave të prokurimit, njoftimet për koncesionet, ppp-të dhe ankandet si dhe njoftime të tjera ku vendin kryesor e zënë njoftimet e administratës publike.

Gjatë vitit 2014 APP ka publikuar **53** Buletine (1 Buletin me shumë se në vitin 2013) me **22.847** faqe në total (5009 faqe më shumë se sa në vitin 2013), ose mesatarisht **431** faqe për Buletin (nga 343 faqe për Buletin në vitin 2013).

Edhe gjatë vitit 2014 Buletini është publikuar vetëm në formë elektronike.

Përveç punës për përmbledhjen e informacionit për publikimin e Buletinit, punonjësit e ngarkuar me kryerjen e publikimit kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në miratimin e njoftimeve të kontratave të hedhura nga Autoritetet Kontraktore, me qëllim publikimin e tyre në sistemin e prokurimit elektronik, ditën e nesërme të punës, sikurse e kërkon legjislacioni i prokurimit publik në fuqi dhe publikimin e tyre në Buletinin vijues.

Konkretisht, gjatë vitit 2014 janë miratuar për publikim në sistemin elektronik dhe janë publikuar në Buletin **5882** njoftime kontratash. Po kështu një rol shumë të rëndësishëm ka pasur funksioni i publikimit në lidhje me miratimin për publikim të njoftimeve të fituesit. Në këtë rast është bërë një koordinim dhe me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave të prokurimit, duke marrë kështu rolin e kontrolluesit dhe monitorimit të respektimit të afateve të ankimit në procedurat e prokurimit.

Gjatë vitit 2014 është ndjekur në sistem zbatimi i rreth **1680** vendimesh të KPP-së dhe janë miratuar për publikim në sistemin elektronik dhe janë publikuar në Buletin **4673** njoftime fituesi.

I njëjti funksion është kryer dhe për miratimin për publikim të njoftimeve të kontratave të nënshkruara në sistem dhe më tej publikimin e tyre në Buletin.

Konkretisht, gjatë këtij viti janë miratuar për publikim **6411** njoftime kontratash të nënshkruara. Buletini ka një rol shumë të rëndësishëm informativ në drejtim të njoftimeve të kontratave të nënshkruara për procedurat me negociim pa shpallje paraprake, të cilat për shkak të natyrës së kësaj procedure, publikohen vetëm në Buletin. Numri i njoftimeve të kontratave të nënshkruara për procedurat me negociim pa shpallje paraprake, të publikuara në Buletin gjatë vitit 2014 ka qënë **2121**.

7. STATISTIKA NË LIDHJE ME NUMRIN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, KONCESIONEVE/PPP DHE ANKANDIT PUBLIK, TË SHPALLURA GJATË VITIT 2014

7.1 Statistika për procedurat e prokurimit të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik

Në këtë pjesë të analizës vjetore do të pasqyrohen dhe interpretohen të dhënat mbi numrin e procedurave të prokurimit publik mbi vlerën 400.000 mijë lekë, të cilat janë shpallur për t'u zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik. Gjithashtu në këtë pjesë do të pasqyrohen dhe të dhënat respektive për numrin e njoftimeve të fituesve si dhe numrin e njoftimeve të kontratave të nënshkruara.

7.1.1

Numri total i njoftimeve të kontratave të procedurave të prokurimit të publikuara gjatë vitit 2014 në sistemin e prokurimit elektronik, sipas llojeve të kontratave, shërbim, mall, punë, në faqen zyrtare të APP-së është **5288** (1136 më shumë se në vitin 2013).

Më poshtë pasqyrohet në mënyrë të detajuar numri i tyre sipas llojit të procedurës së publikuar.

Shërbime		Mallra		Punë	
Lloji i Proedurës	Numri i njoftimeve të procedurave	Lloji i Proedurës	Numri i njoftimeve të procedurave	Lloji i Proedurës	Numri i njoftimeve të procedurave
Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	116	Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi		Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	
E hapur Ndërkombëtar	6	E hapur Ndërkombëtar	4	E hapur Ndërkombëtar	
Procedurë e hapur	316	Procedurë e hapur	577	Procedurë e hapur	474
Kërkesë për Propozim	964	Kërkesë për Propozim	2022	Kërkesë për Propozim	803
Procedurë e kufizuar lokal	4	Procedurë e kufizuar lokal	2	Procedurë e kufizuar lokal	
TOTALI	1406	TOTALI	2605	TOTALI	1277

Në formë tabelore, të dhënat për numrin e procedurave të prokurimit publik, të ndara sipas llojit të procedurës, **të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik** për vitin 2014, dhe fondet limite përkatëse, janë si më poshtë:

Nr.Total i Proedurave të shpallura	5288
Fondi total limit i procedurave të shpallura	60,105,670,018
shërbim konsulence dhe konkurs projektimi nr	116
shërbim konsulence dhe konkurs projektimi në vlerë	1,579,789,518
I hapur ndërkombëtar nr	10
i hapur nderkombëtar në vlerë	7,729,669,579
I hapur lokal nr	1367
I hapur lokal në vlerë	42,580,100,073
kërkesë për propozim nr	3789
kërkesë për propozim vlerë	7,958,820,848
I kufizuar lokal nr	6
I kufizuar lokal vlerë	257,290,000

7.1.2 Statistika sipas llojit të procedurave

Numri total i njoftimeve të fituesit të procedurave të prokurimit të publikuara gjatë vitit 2014 në sistemin e prokurimit elektronik, sipas llojeve të kontratave, shërbim, mall, punë, në faqen zyrtare të APP-së është **4605** (1166 më shumë se në vitin 2013).

Në formë tabelore, të dhënat për procedurat e prokurimit elektronik, të ndara sipas llojit të procedurës, dhe fondeve përkatëse, të zhvilluara dhe të përfunduara me fitues në sistem gjatë vitit 2014 janë si më poshtë:

Llojet e procedurave	Nr.Total i procedurave	Fondi limit total i prokuruar	Fondi total i ofruar(tenderuar)	% që zë Fondi i ofruar ndaj Fondit limit të prokuruar	Fondi total i kursyer	% që zë Fondi i kursyer ndaj Fondit limit të prokuruar
Procedure hapur ndërkombëtare (njoftim fituesi)	16	4,712,456,723	4,647,932,567	98.6%	64,524,156	1.4%
Procedure hapur (njoftim fituesi)	1523	32,470,275,123	29,516,627,091	90.9%	2,953,648,032	9.1%
Kërkesë për propozim (njoftim fituesi)	3060	6,052,194,449	5,321,599,929	87.9%	730,594,519	12.1%
Shërbim konsulence, konkurs projektimi (njoftim fituesi)	73	445,542,869	422,817,040	94.9%	22,725,829	5.1%
I Kufizuar Lokal	1	725,000	555,500	76.6%	169,500	23.4%
Totali	4673	43,681,194,164	39,909,532,128	91.4%	3,771,662,036	8.6%

7.1.3

Numri total i njoftimeve të kontratave të nënshkruara të procedurave të prokurimit të publikuara gjatë vitit 2014 në sistemin e prokurimit elektronik, sipas llojeve të kontratave, shërbim, mall, punë, në faqen zyrtare të APP-së është **6411** (2649 më shumë se në vitin 2013).

Shërbime		Mallra		Punë	
Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të procedurave	Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të procedurave	Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të procedurave
Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	75	Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi		Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	
E hapur Ndërkombëtar	1	E hapur Ndërkombëtar	175	E hapur Ndërkombëtar	
Procedure hapur	286	Procedure hapur	2737	Procedure hapur	378
Kërkesë për Propozim	658	Kërkesë për Propozim	1480	Kërkesë për Propozim	621
TOTALI	1020	TOTALI	4392	TOTALI	999

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelat e mësipërme, rezulton se numri total i procedurave të shpallura në sistemin elektronik janë **5288**, ndërkohë që numri i procedurave të fituara (të cilat maten me njoftimet e fituesve të publikuar në sistem) është **4605**. Diferenca midis numrit të procedurave të shpallura me ato të përfunduara me njoftim fituesi në sistem, shpjegohet me faktin se disa nga procedurat e shpallura janë anuluar (për arsye të ndryshme të cilat do të analizohen më poshtë), ose janë procedura të cilat janë shpallur në fund të vitit 2014 dhe nuk janë përfunduar ende me njoftimin e fituesit (janë në proces).

Gjithashtu, po nga tabelat më sipër rezulton se numri i kontratave të nënshkruara është më i madh se numri i fituesve. Kjo diferencë shpjegohet me faktin se disa procedura janë zhvilluar në mënyrë të përqëndruar (nga Organi Qendror Blerës, ose Ministri të ndryshme që kanë shërbyer si organ qendror për institucionet e veta të varësisë), dhe në këtë rast, fituesi është një, kurse kontrata të nënshkruara janë aq sa është dhe numri i institucioneve përfituese nga kjo procedurë.

7.1.4 Statistika mbi % e kursyer

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen të dhënat për numrin e procedurave të prokurimit publik, fondin limit përkatës, numrin e procedurave të fituara me fondin limit dhe fondin e ofruar përkatës si dhe kursimin në %, të zhvilluara në sistemin elektronik gjatë vitit 2014.

Nr.Total i Proçedurave të publikuara	5,288
Fondi total limit i proçedurave të publikuara	60,105,670,018
Nr.Total i Proçedurave të cilat kanë vazhduar	3,879
Fondi total limit i proç.të cilat kanë vazhduar	50,407,013,534
Nr.Total i Proçedurave të papërfunduara (anulluar, pezulluara, etj)	1,409
Fondi total limit i proç.të papërfundura(anulluar, pezulluar, etj)	9,698,656,484
Nr.Total i Proç.të fituara	4,673
Fondi total limit	43,681,194,164
Fondi total i prokuruar	39,909,532,128
% që zë Fondi i prokuruar ndaj Fondit limit	91.4%
Fondi total i kursyer	3,771,662,036
% që zë Fondi i kursyer ndaj Fondit limit	8.6%

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën më sipër, rezulton se nga 5288 procedurat e shpallura për t'u zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik, 1409 prej tyre janë anuluar.

Për të kuptuar dhe analizuar drejt këtë shifër (e cila në pamje të parë është relativisht e lartë, po të kemi në konsideratë numrin total të procedurave të shpallura), duhet të kemi në konsideratë faktin që duke qënë se këto procedura zhvillohen në formë elektronike, ka dy arsye kryesore anulimi: a) arsye teknike dhe b) arsye ligjore.

Ndër arsyet teknike përmendim kryesisht gabimet në plotësimin/kryerjen e hapave në sistemin e prokurimit elektronik, të cilat gjatë vitit 2014 kanë zënë një vend të konsiderueshëm. Një shpjegim për këtë situatë është mungesa e eksperiencës së stafit të ngarkuar me kryerjen e procedurave të prokurimit, në Autoritetet Kontraktore.

Ndër arsyet ligjore që çojnë në anulimin e procedurave përmendim vendimet e anulimit nga Komisioni i Prokurimit Publik, mungesë konkurrence gjatë zhvillimit të procedurave, anulimeve për shkak të mbylljes së vitit buxhetor, etj.

Një rast tjetër që vlen të përmendet në funksion të kësaj analize është dhe rasti kur shpallet një procedurë me lote dhe anulohen një ose disa lote të saj. Në këtë rast numri i procedurës së shpallur është vetëm një, ndërkohë që për këtë procedurë të shpallur do të numërohen si procedura të anuluar çdo lot i mëvetshëm, nëse është rasti.

7.1.5

Nga krahasimi i të njëjtëve tregues, nga viti 2013 në vitin 2014 ka një rritje në numrin e procedurave të shpallura për t'u zhvilluar në sistemin elektronik, rritje në numrin e procedurave që kanë përfunduar me njoftim fituesi, rritje të fondit të prokuruar dhe rritje të fondit të kursyer.

Më konkretisht, këto të dhëna pasyrohen në tabelën përmbledhëse, krahasuese, si më poshtë:

Viti	2013	2014
Nr.Total i Proçedurave të publikuara	4,152	5,288
Fondi total limit i proçedurave të publikuara	52,181,980,979	60,105,670,018
Nr.Total i Proçedurave të cilat kanë vazhduar	3,520	3,879
Fondi total limit i proç.të cilat kanë vazhduar	48,617,647,873	50,407,013,534
Nr.Total i Proçedurave të papërfundura(anulluar,etj)	632	1,409
Fondi total limit i proç.të papërfundura(anulluar,etj)	3,564,333,106	9,698,656,484
Nr.Total i Proç.të fituara	3,439	4,673
Fondi total limit	43,922,603,793	43,681,194,164
Fondi total i prokuruar	40,701,653,730	39,909,532,128
% që zë Fondi i prokuruar ndaj Fondit limit	92.7%	91.4%
Fondi total i kursyer	3,220,950,063	3,771,662,036
% që zë Fondi i kursyer ndaj Fondit limit	7.3%	8.6%

7.1.6 Të dhëna mbi procedurat e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit

Përveç procedurave të prokurimit publik të shpallura për tu zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik, sipas legjislacionit të prokurimit publik në fuqi, Autoritetet

Kontraktore, nëse ndodhen në kushtet e parashikuara nga ligji, mund të kryejnë dhe procedura prokurimi me negociim pa shpallje paraprake.

Në formë tabelore, të dhënat për prokurimin elektronik dhe procedurat negociim pa shpallje paraprake të njoftimit si dhe raportet në % dhe fondi i kursyer në total, për vitin 2014 janë si më poshtë:

Nr.Total i Proedurave të publikuara elektronike	5,288
Fondi total limit i proedurave të publikuara elektronike	60,105,670,018
Nr.Total i Proç të fituara elektronike	4,673
Fondi total limit i proedurave të fituara elektronike	43,681,194,164
Fondi total i prokuruar i proç të fituara elektronike	39,909,532,128
Nr.Total i Proç të fituara Negoc pa shpallje	2,121
Fondi total limit i prokuruar negoc pa shpallje	5,646,826,542
Fondi total i ofruar negoc pa shpallje	5,566,688,557
% që zë nr I proç të fituara negoc pa shpallje ndaj nr total të procedurave të fituara(elektronik+negociim pa shpallje)	31.2%
% që zë fondi limit I proçed me negoc pa shpallje ndaj fondit limit total (elektronik + negociim pa shpallje) për procedurat e fituara	11.4%
% që zë fondi I ofruar proçed me negoc pa shpallje ndaj fondit total (elektronik + negociim pa shpallje) për procedurat e fituara	12.2%
Nr.Total i Proç të fituara (elektronik + negociim pa shpallje)	6,794
Fondi total limit i prokuruar i proç të fituara (elektronik + negociim pa shpallje)	49,328,020,706
Fondi total i ofruar i proç të fituara (elektronik + negociim pa shpallje)	45,476,220,685
% që zë Fondi i ofruar ndaj Fondit limit të prokuruar	92.2%
Fondi total i kursyer	3,851,800,021
% që zë Fondi i kursyer ndaj Fondit limit të prokuruar	7.8%

Sikurse shihet dhe nga tabela, gjatë vitit 2014 janë zhvilluar **2121** procedura me negociim pa publikim të njoftimit të kontratës.

Për të analizuar dhe lexuar drejt këtë të dhënë, duhet të kemi në konsideratë këto situata:

- Pothuajse të gjitha autoritetet kontraktore, kryejnë procedura negociim pa shpallje, për një vlerë deri në 20% të kontratës së fundit, për të përmbushur nevojat e fillim vitit, një mundësi kjo e rregulluar nga legjislacioni në fuqi.
- Përdorimi i kësaj procedure bëhet i domosdoshëm dhe në kushtet kur krijohen situatë emergjente (sidomos për mallra dhe shërbime të domosdoshme, si ushqime, shërbime

pastrimi etj) “të stimuluar” nga legjislacionet e tjera dhe sidomos ai për buxhetin. Konkretisht, duke qenë se aktualisht, në bazë të akteve të nxjerra në zbatim të legjislacionit për menaxhimin e sistemit buxhetor, nuk lejohet fillimi i një procedure prokurimi në rast se nuk ka kaluar buxheti përkatës, në llogarinë e Autoritetit Kontraktor (e konkretizuar kjo me kërkesën për të vulosur Urdhrin e Prokurimit në degën përkatëse të Zyrës së Thesarit), lidhja e një kontrate nga një procedurë konkuruese prokurimi nuk mund të realizohet minimalisht përpara muajit Mars të një viti (nga praktika e deri tanishme për shkak dhe të afateve të ankimit kjo periudhë shkon në muajt Prill-Maj të vitit).

Në këto kushte, Autoritetet Kontraktore (pasi kanë ezauruar dhe procedurat me negociim pa shpallje për nevojat e fillimi vitit, sikurse analizuar më sipër), ndodhen përsëri në “situatë emergjente” për mallra dhe shërbime të domosdoshme, situatë që i çon në përdorimin e procedurës negociim pa shpallje.

Theksojmë se në ndryshim nga aktet e sipërpërmendura, legjislacioni i prokurimit e lejon fillimin e procedurës së prokurimit që me miratimin e buxhetit (pra pa pasur nevojë që buxheti të ketë kaluar në llogarinë e AK-së) deri në shpalljen e fituesit dhe nuk lejon lidhjen e kontratës pa kaluar buxheti respektiv në llogarinë e AK-së, duke mos u bërë pengesë administrative për zhvillimin e procedurës konkuruese.


- Një arsye tjetër e “stimulimit të procedurave me negociim pa shpallje paraprake, janë tejzgjatja e procedurave të prokurimit, sidomos në rastet kur ka një ankesë në shkallë të dytë administrative, Komisionin e Prokurimit Publik. Në disa prej rasteve të monitoruara nga APP, justifikimi i autoriteteve kontraktore për përdorimin e kësaj procedure ka qenë mos përfundimi i procedurës konkuruese, për shkak të shqyrtimit të ankesës në KPP.
- Arsye tjetër e shpeshtë për përdorimin e kësaj procedure, e lidhur kjo me objektet e prokurimit që mbulohen nga Organi Qendror Blerës, janë nevojat e pambuluara për shkak të kohës që duhet për zhvillimin e një procedure prokurimi nga OQB, e cila nga praktika e deri tanishme, nuk përfundon më parë se muaji Prill-Maj i vitit.

Në funksion të analizës së shkaqeve që çojnë në përdorimin e procedurës negociim pa shpallje paraprake, sikurse parashtruar më sipër, shërbejnë të dhënat e pasyruara në tabelën e mëposhtme, nga ku evidentohet qartë që gati gjysma e të gjithë procedurave me negociim pa shpallje paraprake të zhvillura gjatë vitit 2014 (1092 nga 2121), janë realizuar vetëm në periudhën Janar-Mars të vitit 2014.


Nr.Total i Proç.të fituara	1092
Fondi total limit i prokuruar	1,709,996,852
Fondi total i ofruar pa tvsh	1,694,561,612
% që zë fondi total i ofruar ndaj fondit limit të prokuruar	99.1%
Fondi total i kursyer	15,435,240
% që zë fondi i kursyer ndaj fondit limit të prokuruar	0.9%

Po kështu, sipas të dhënave të ilustruara me diagramat e mëposhtme, rezulton se përqindja më e madhe si në numër ashtu edhe në vlerë, i procedurave me negociim pa shpallje paraprake, janë realizuar në katërmujorin e parë të vitit 2014.

% e numrit të procedurave me negociim pa shpallje paraprake të zhvilluara gjatë vitit 2014, e ndarë në 4 mujore.



% e fondit të prokuruar me procedurat me negociim pa shpallje paraprake të zhvilluara gjatë vitit 2014, e ndarë në 4 mujore.



Me qëllim minimizim e rasteve të përdorimit të procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit, është e rëndësishme, së pari të koordinohen sistemi buxhetor me atë të prokurimit, pra të stimulohet zhvillimi i procedurës së prokurimit edhe pa kaluar ende buxheti në llogarinë e Autoriteteve Kontraktore (me kushtin që të mos lejohet të lidhin kontratë nëse nuk e kanë buxhetin përkatës), duke fituar kështu kohën e nevojshme për zhvillimin e procedurës konkurruese të prokurimit dhe duke shmangur stimulimin e situatave fiktive të emergjencës që i çojnë autoritetet kontraktore në zhvillimin e procedurave me negociim pa shpallje paraprake.

Gjithashtu, në kuadër të kësaj mase, është shumë e rëndësishme disiplinimi i afateve të dy institucioneve kryesore që ndikojnë drejtëpërsëdrejti në përmbushjen në kohë, ose jo të një nevojë të AK-së, sikurse janë KPP dhe OQB, për arsyet e analizuara më sipër.

Megjithë analizën e mësipërme dhe numrin e procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, vlen të theksohet fakti se, fondi limit i prokuruar me këtë lloj procedure është më i ulët në vitin 2014, krahasuar me vitin 2013.

Për ta konkretizuar më poshtë pasqyrohen të dhënat në një tabelë përmbledhëse dhe krahasuese midis viteve 2013 dhe 2014.

Viti	2013	2014
Nr.Total i Proçedurave të publikuara elektronike	4,152	5,288
Fondi total limit i proçedurave të publikuara elektronike	52,181,980,979	60,105,670,018
Nr.Total i Proç.të fituara elektronike	3,439	4,673
Fondi total limit i proçedurave të fituara elektronike	43,922,603,793	43,681,194,164
Fondi total i prokuruar i proç të fituara elektronike	40,701,653,730	39,909,532,128
Nr.Total i Proç.të fituara Negoc pa shpallje	1,713	2,121
Fondi total limit i prokuruar negoc pa shpallje	8,459,515,339	5,646,826,542
Fondi total i ofruar negoc pa shpallje	8,202,656,551	5,566,688,557
% që zë nr I proç të fituara negoc pa shpallje ndaj nr total të procedurave të fituara(elektronik+negociim pa shpallje)	33.2%	31.2%
% që zë fondi limit I proçed me negoc pa shpallje ndaj fondit limit total (elektronik + negociim pa shpallje) për procedurat e fituara	16.1%	11.4%
% që zë fondi I ofruar proçed me negoc pa shpallje ndaj fondit total (elektronik + negociim pa shpallje) për procedurat e fituara	16.8%	12.2%
Nr.Total i Proç.të fituara (elektronik + negociim pa shpallje)	5,152	6,794
Fondi total limit i prokuruar i proç të fituara (elektronik + negociim pa shpallje)	52,382,119,132	49,328,020,706
Fondi total i ofruar i proç të fituara (elektronik + negociim pa shpallje)	48,904,310,281	45,476,220,685
% që zë Fondi i ofruar ndaj Fondit limit të prokuruar	93.4%	92.2%
Fondi total i kursyer	3,477,808,851	3,851,800,021
% që zë Fondi i kursyer ndaj Fondit limit të prokuruar	6.6%	7.8%

7.1.7 Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël

Përveç procedurave me vlerë mbi vlerën kufi për prokurimin me vlerë të vogël (400.000 lekë pa tvsh), në sistemin e prokurimit elektronik, që prej vitit 2013 zhvillohen dhe procedurat e prokurimit me vlerë të vogël. Të dhënat e vitit 2014 në këtë drejtim janë tregues i qartë i shkallës së lartë të përdorimit të sistemit elektronik nga AK-të.

Numri i procedurave të kryera gjatë vitit 2014, është rritur ndjeshëm krahasuar me numrin e kësaj lloji procedure, të kryer në vitin 2013 dhe konkretisht, gjatë vitit 2014 janë kryer 46,537 procedura, ndërkohë që gjatë vitit 2013 u kryen 28778 procedura.

Po kështu, numri i procedurave të përfunduara me sukses gjatë vitit 2014 është më i lartë krahasuar me vitin 2013 dhe konkretisht, procedurat me vlerë të vogël, të përfunduara me sukses në sistemin e prokurimit elektronik, gjatë vitit 2014 është 31.164, ndërkohë që gjatë vitit 2013 ka qënë 17329.

Të dhëna më të detajuara për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, të kryera në sistemin e prokurimit elektronik gjatë vitit 2014, pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Nr Total i Blerje me Vlerë të Vogël	46,537
Fondi total limit i Blerje me Vlerë të Vogël	9,175,402,305
Fondi total i prokuruar i Blerje me Vlerë të Vogël	7,846,040,916
Nr.Total i Blerje me Vlerë të Vogël të cilat kanë vazhduar	31,164
Nr.Total i Proçedurave të papërfundura(anulluar,etj)	15,373
% që zë Fondi i prokuruar ndaj Fondil limit	85.5%
Fondi total i kursyer	1,329,361,389
% që zë Fondi i kursyer ndaj Fondit limit	14.5%

7.2 Statistika në lidhje me numrin e procedurave të dhënies me koncesion/ppp

Numri i procedurave për dhënien me koncesion/ppp, të shpallura për t'u zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik si dhe numri i procedurave të anulhuara, paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Procedura për dhënien me koncesion /ppp	Numri i procedurave
Procedura të shpallura për t'u zhvilluar	9
Procedura të përfunduara me fitues	6
Procedura në proces	3
Procedura të anulhuara (të shpallura për t'u zhvilluar gjatë vitit 2013)	36

7.3 Statistika në lidhje me procedurat e ankandit publik të zhvilluara gjatë vitit 2014

Gjatë vitit 2014 janë shpallur në Buletin e Njoftimeve Publike dhe procedura të ankandit publik, procedura këto të cilat zhvillohen vetëm në rrugë shkresore. Numri i njoftimeve të fituesit dhe kontratave të nënshkruara, si dhe vlerat respektive, për procedurat e ankandit për vitin 2014, paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Procedura të ankandit publik	Nr	Vlera e ofertuar
Ankande fitues	222	806,775,564
Ankande kontrata	102	372,205,609

8. TREGUESIT E VEPRIMTARISË PËR DREJTORINË E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Gjatë vitit 2014, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit (këtu e në vijim DTI) në bashkëpunim dhe me institucione si Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ka bërë përmirësime të ndjeshme në infrastrukturën e Sistemit të Prokurimit Elektronik (këtu e në vijim SPE) me qëllim rritje e sigurisë së këtij sistemi. Ky bashkëpunim ka rezultuar i suksesshëm në ofrimin e sigurisë për SPE dhe Sistemin e Arkivës Elektronike të SPE.

Disa nga veprimtaritë kryesore, të kryera në këtë drejtim janë:

- DTI ka përfunduar me sukses procesin *upgrade* të sistemit të operimit dhe të databazës në periudhën 13.03.2014 – 24.05.2014, të cilët tashmë operojnë me Windows 2012 R2 dhe SQL Server 2008. Si rezultat i këtij procesi, në termat e teknologjisë së informacionit, SPE ka pësuar rritje të performancës dhe sigurisë së informacionit. Gjithashtu, ky zhvillim jep një impakt shumë pozitiv për sa i përket aksesimit të sistemit, duke lehtësuar akoma më tepër punën e përdoruesve të tij.
- Gjithashtu, nga DTI janë marrë masat për instalimin e çertifikatës së re të sigurisë SSL (*Secure Socket layer*) duke mundësuar që komunikimi ndërmjet userave dhe sistemit të jetë i sigurt, pa asnjë ndërprerje. Tashmë SPE është i pajisur me çertifikatë sigurie të ofruar nga “*GlobalSign GMO Internet Group*” deri në datën 06.07.2016.
- Në muajin Dhjetor 2014, DTI ka implementuar me sukses shërbimin e *Upgrade dhe implementimin e zgjidhjes Back Up me tape* për SPE, duke rritur në këtë mënyrë sigurinë e të dhënave që ruhen në të.
- Është bërë rritja e kapaciteteve hardware të serverave (shtimi i RAM).
- Zgjidhja e problematikave të ndryshme hardware dhe software, gjatë punës së përditshme.

- Përmirësimi i vazhdueshëm i ndërfaqes, me qëllim përmirësimin dhe lehtësimin e punës së përdoruesve të SPE.

Gjithashtu, detyra të tjera të DTI, gjatë vitit 2014, kanë qenë:

- Përgatitja dhe publikimi i vazhdueshëm i njoftimeve dhe udhëzimeve në lidhje me arkivimin e procedurave nga Autoritetet Kontraktore. Procesi i arkivimit bën të mundur që sistemi operacional, në të cilin kryhen të gjitha procedurat e prokurimit publik, të lehtësohet ndjeshëm duke ulur gjithmonë e më shumë numrin e procedurave që ndodhen në të, e për pasojë duke lehtësuar punën e përdoruesve të sistemit (Autoritete Kontraktore, Operatorë Ekonomikë, Auditues).
- Pasurimi i faqes zyrtare të internetit të APP-së, me informacion të përditësuar në lidhje me procesin e prokurimit, nëpërmjet publikimit të materialeve si më poshtë:
 - Publikimi i **53** buletinëve javorë.
 - Publikimi i legjislacionit të përditësuar, vendimeve, udhëzimeve, raporte, module trajnimesh etj, në total **23 dokumenta**.
 - Publikimi i **22** njoftimeve të ndryshme të aspektit teknik, në lidhje me funksionimin e sistemit.
 - Publikimi i Dokumentave Standarte të Tenderit të reja, në total **30 dokumenta**.

Disa nga çështjet kyçe të cilave u është kushtuar një rëndësi e veçantë dhe e përhershme, janë:

- Monitorimi i infrastrukturës fizike të SPE dhe Sistemit të Arkivës Elektronike.
- Monitorimi i performancës së komponentëve hardëare në SPE dhe në Sistemin e Arkivës Elektronike.
- Monitorimi i performancës së aplikimit në SPE dhe në Sistemin e Arkivës Elektronike.
- Monitorimi i vazhdueshëm i bazës së të dhënave në SPE dhe në Sistemin e Arkivës Elektronike.
- Kryerja e Backup –it si dhe ruajtja e tij në Datacenter-in e AKSHI –it.
- Përmirësimi i vazhdueshëm i sigurisë së SPE dhe Sistemit të Arkivës Elektronike.

DTI është përpjekur maksimalisht për të mbajtur “online” SPE, 24 orë në 7 ditë të javës, përveç rasteve kur nxjerrja e tij “offline” për një periudhë të caktuar, është bërë e domosdoshme për kryerjen e shërbimeve përkatëse. Në çdo rast nxjerrja “offline” e SPE, është paralajmëruar me anë të një njoftimi në faqen zyrtare të APP-së. Qëndrimi në gadishmëri jashtë orarit zyrtar të punës gjatë fundjavës si dhe ditëve të cilat janë festa zyrtare të specialistëve të DTI, duke monitoruar ecurinë e punës në SPE dhe në Sistemin e Arkivës, kanë qënë në total rreth 2400 orë për vitin 2014.

Rezultati i punës së DTI ka qënë administrimi i sigurt i një totali të dhënash prej:

561 GB (602,749,889,024 bytes) të Sistemit të Prokurimit Elektronik, dhe
6.58 TB (7,234,786,510,766.08 bytes) të Sistemit të Arkivës Elektronike.

8.1 Dhënia e asistencës teknike brenda dhe jashtë APP-së

M bështetja teknike që u jepet të gjitha autoriteteve kontraktore si dhe të gjithë operatorëve ekonomikë të huaj dhe vendas të cilët përdorin spe, nëpërmjet e-mail-eve, telefonit apo dhe konsultimeve në ambientet e APP-së, është një punë e përditshme për këtë drejtori. Këtu vlen të përmendet se numri i telefonatave të marra nga drejtorja ka qënë rreth **60** telefonata në ditë.

Gjatë vitit 2014 DTI ka përgatitur:

- **2230** shkresa në total, ku përfshihen:
 - Krijim llogarie në rolin CA Admin dhe Operator Ekonomik, si dhe rikthim fjalëkalimi në gjëndje fillestare;
 - Shkresa sqaruese për Autoritetet Kontraktore dhe Operatorët Ekonomikë;
 - Shkresa për dërgim të dhënash dhe bashkëpunim me institucionet e tjera;
 - Memo të brendshme dhe memo për bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të Monitorimit dhe Publikimit.
- **3340** e-maile në total, drejtuar:
 - operatorëve ekonomikë (për konfirmimin e regjistrimeve të bëra online, për rikthim të fjalëkalimit në gjëndjen fillestare, për sqarime, udhëzime dhe ankesa);
 - autoriteteve kontraktore (për sqarime dhe udhëzime të karakterit teknik); institucioneve të tjera (për dërgim të dhënash dhe informacionesh);

Dhënia e asistencës teknike nga kjo drejtori është bërë edhe nëpërmjet trajnimeve të ndryshme, të organizuar nga APP dhe Shkolla e Administratës Publike, ku specialistë të IT, kanë mbuluar sesionet mbi përdorimin e sistemit elektronik të prokurimeve.

Gjatë vitit 2014, DTI ka punuar intensivisht me Drejtorinë Juridike, Monitorimit dhe Publikimit për përmirësimin e manualeve dhe udhëzimeve për përdoruesit e SPE, të cilat janë përshkruar më sipër, në këtë analizë. Këto udhëzime janë shumë të detajuara dhe me pamje nga sistemi, duke ndjekur teknikisht çdo fazë të procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, parë nga të gjithë rolet e përdoruesve të SPE.

Bashkëpunimi i DTI me Drejtorinë Juridike, të Monitorimit dhe Publikimit ka qënë shumë produktiv edhe për sa i përket evidentimit të rasteve problematike dhe zgjidhjen e tyre si dhe në përmirësimin e sistemit të prokurimit elektronik, konform legjislacionit në fuqi.

8.2. Krijimi i përdoruesve të rinj për vitin 2014

Për vitin 2014 në sistemin e prokurimit elektronik janë krijuar, **9233** përdorues të rinj dhe përkatësisht:


Nga DTI gjatë vitit 2014 janë krijuar **91** llogari të reja “Administrator” për Autoritetet Kontraktore në SPE. Numri total i Autoriteteve Kontraktore që përdorin SPE shkon në **2193**.

Nga këto Autoritete Kontraktore gjatë vitit 2014 janë krijuar:

- **3858** llogari përdoruesi për anëtarët e Njesisë së Prokurimit,
- **4715** llogari të Komisionit të Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave,
- **569** llogari të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave dhe atë të Auditit.


Aktualisht numri total i përdoruesve nga autoritet kontraktore është **34713**.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet numri i përdoruesve të sistemit të prokurimit elektronik, brenda Autoriteteve Kontraktore, të krijuar përkatësisht në vitet 2011, 2012, 2013 dhe 2014. Nga figura shihet qartë numri më i madh i përdoruesve të krijuar në vitin 2013, krahasuar me vitet 2011, 2012 dhe 2014. Kjo diferencë shpjegohet me kryerjen **për herë të parë** të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, në formë elektronike gjatë vitit 2013.




Për vitin 2014, në sistemin e prokurimit elektronik në rolin e operatorëve ekonomikë janë regjistruar **1580** operatorë ekonomikë të rinj, nga të cilët **173** janë operatorë ekonomikë të huaj.

Në diagramën e mëposhtme paraqitet numri i përdoruesve të rinj të sistemit të prokurimit elektronik, nga operatorët ekonomikë, të krijuar përkatësisht në vitet 2011, 2012, 2013 dhe 2014. Këtu vihet re qartë numri i madh i përdoruesve të krijuar në vitet 2013 dhe 2014, krahasuar me vitet 2011 dhe 2012. Kjo diferencë shpjegohet me kryerjen për herë të parë gjatë vitit 2013 dhe në vijim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, në formë elektronike.



Gjithashtu më poshtë paraqitet diagrama e operatorëve ekonomikë të huaj sipas shteteve, të regjistruar në SPE:




Puna e përditshme e DTI konsiston edhe në suportin e përdoruesve brenda APP si dhe në menaxhimin e infrastrukturës së rrjetit të brendshëm kompjuterik dhe telefonik.

8.3 Statistika në lidhje me procedurat e krijuara në sistemin elektronik

Numri total i aplikimeve të krijuara nga Njësitë e Prokurimit pranë Autoriteteve Kontraktore për vitin 2014 në Sistemin e Prokurimit Elektronik është **55.536**, nga cilat:

- **46.537** janë aplikime për Blerje me Vlerë të Vogël, nga të cilat **31.164** janë përfunduar me fitues.
- **8.999** janë aplikime për procedura konsulence, konkurs projektimi, procedura me negociim me shpallje paraprake të njoftimit, procedura të hapura, kërkesë për propozim, procedura të kufizuara, mbi dhe nën kufirin e lartë monetar, nga të cilat **5.288** janë publikuar dhe kanë pritur oferta në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Në diagramën e mëposhtme tregohet raporti i numrit të prokurimeve me vlerë të vogël, ndaj procedurave mbi vlerën 400.000 lekë, ku sikurse dhe nga treguesit e analizuar më sipër del qartë volumi më i madh që zënë procedurat e prokurimit me vlerë të vogël ndaj procedurave të tjera.



8.4 Statistika në lidhje me ofertat e krijuara në sistemin elektronik për procedurat me vlerë mbi 400.000 lekë


Gjatë vitit 2014 nga operatorët ekonomikë, në SPE janë paraqitur 27.656 oferta të konfirmuara, nga të cilat:

- 14.143 oferta të kualifikuara;
- 13.513 oferta të s'kualifikuara.

Në grafikun e mëposhtëm pasqyrohet raporti i Ofertave të kualifikuara nga Komisionet e Vleresimit të Ofertave, ndaj atyre të skualifikuara.

Oferta të kualifikuara	14143
Oferta të s'kualifikuara	13513

Raporti i ofertave të kualifikuara ndaj ofertave të s'kualifikuara




8.5 Statistika të tjera në lidhje me përdorimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik.

Në Sistemin e Prokurimit Elektronik, për vitin 2014 në total kemi:

Hits	
Total Hits	133,321,060
Visitor Hits	133,166,378
Spider Hits	154,682
Average Hits per Day	757,506
Average Hits per Visitor	206.98
Cached Requests	47,597,694
Page Views	
Total Page Views	57,721,620
Average Page Views per Day	327,963
Average Page Views per Visitor	89.71
Visitors	
Total Visitors	643,393
Average Visitors per Day	3,655
Total Unique IPs	52,374

Grafiku i mëposhtëm pasqyron shpërndarjen e vizitorëve/ditë dhe klikimeve/ditë sipas muajve:







Më poshtë jepet aktiviteti i përdoruesve sipas orëve të ditës. Sipas këtij grafiku rezulton se orari më i ngarkuar është gjatë orarit zyrtar, megjithatë nga të dhënat duket qartë që sistemi është përdorur edhe gjatë orëve të natës:



Gjithashtu, grafiku i mëposhtëm ilustron aktivitetin e përdoruesve gjatë ditëve të javës, ku duket qartë që ky sistem përdoret dhe gjatë ditëve të fundjavës:



Grafiku i mëposhtëm pasqyron aktivitetin e përdoruesve sipas muajve:




8.6 Statistika në lidhje me përdorimin e Arkivës Elektronike të Sistemit të Prokurimit Publik.

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen statistikën e aksesimit të Sistemit të Arkivës Elektronike të Prokurimit Publik.

Hits	
Total Hits	1,507,795
Visitor Hits	1,491,774
Spider Hits	16,021
Average Hits per Day	4,188
Average Hits per Visitor	69.95
Cached Requests	516,547
Page Views	
Total Page Views	609,443
Average Page Views per Day	1,692
Average Page Views per Visitor	28.58
Visitors	
Total Visitors	21,326
Average Visitors per Day	59
Total Unique IPs	5,976


Grafiku i mëposhtëm pasqyron shpërndarjen e vizitorëve/ditë dhe klikimeve/ditë sipas muajve:




Më poshtë jepet aktiviteti i përdoruesve sipas orëve të ditës. Sipas këtij grafiku rezulton se orari më i ngarkuar është në mesditë:



Gjithashtu, grafiku i mëposhtëm ilustron aktivitetin e përdoruesve gjatë ditëve të javës, ku duket qartë që ky sistem përdoret dhe gjatë ditëve të fundjavës:



Grafiku i mëposhtëm pasqyron aktivitetin e përdoruesve sipas muajve:



9. TREGUESIT E VEPRIMTARISË NË DREJTIM TË MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE, INTEGRIMIT, DHE FINANCËS.

9.1. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Sikurse është parashtruar që në fillim të kësaj analize, edhe gjatë vitit 2014, Agjencia e Prokurimit Publiklik, e ka ushtruar aktivitetin e saj ligjor me 23 punonjës të ndarë në dy drejtori kryesore; Drejtorinë Juridike, të Monitorimit dhe Publikimit dhe Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 152/ 2013 “Për nëpunësin Civil” , datë 06.02.2014 në Agjencinë e Prokurimit Publik u bë edhe verifikimi i dokumenacionit të emërimit për çdo punonjës, dhe në fund të këtij procesi, Departamenti i Administratës Publike si institucioni përgjegjës për deklarimin e statusit të të punësuarit, konform dispozitave ligjore konfirmoi si me poshtë:

- 1 (një) janëtar TND- Drejtori i Përgjithshëm i APP-së;
- 16 (gjashtëmbëdhjetë) nëpunës civilë të konfirmuar-(2 Drejtor Drejtorie +14 specialistë);
- 4 (katër) nëpunës civilë në periudhë prove në nivelin specialist;
- 2(dy) punonjës me kontratë shërbimi;

9.1.1 Autoriteti Përgjegjës

Autoriteti Përgjegjës në institucion ka mbajtur në mënyrë të rregullt kontaktet me Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe ka raportuar emrat e personave përgjegjës për deklarimin e pasurive në institucion, si dhe ka dërguar në kohë Deklarimet përkatëse.

Gjatë këtij viti Agjencia e Prokurimit Publik në përputhje me detyrimin ligjor “për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe nëpunësve publik”, ka depozituar në kohë Deklarimin e Interesave Privatë Periodik/Vjetor, para fillimit të detyrës dhe pas largimit nga detyra për zyrtarët përkatës.

9.1.2 Aktivitetet në drejtim të fuqizimit të kapaciteteve administrative të stafit të APP-së dhe specialistëve të prokurimit publik pranë autoriteteve kontraktore

9.1.2.a Pjesëmarrja në aktivitete ndërkombëtare të stafit të APP

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve administrative, gjatë vitit 2014 përfaqësues të Agjencisë së Prokurimit Publik kanë marrë pjesë në një sërë takimesh dhe seminaresh të organizuar brenda dhe jashtë vendit dhe konkretisht si më poshtë:

Në datat 27-29 Maj 2014, APP u përfaqësua në Konferencën e 2-të Europiane për prokurimin publik në Lisbonë me tematikë "Prokurimi Publik nga ai me letër në prokurimin elektronik".

Në datat 27-30 Maj 2014, 2 (dy) përfaqësues të APP-së morën pjesë në Platformën e 10-të të shkëmbimit të njohurive në prokurimin publik me temë "Matja e performacës në prokurimin publik" në Turqi.

Në datat 9-10 Shtator 2014 u zhvillua në bashkëpunim me SIGMA-n, Konferenca e Shtatë Rajonale - IPA e prokurimit publik, u në qytetin e Vlorës, ku APP u përfaqësua me 5 (pesë) punonjës të saj.

9.1.2.b Trajnimet e stafit të APP-së

Stafi i Agjencisë së Prokurimit Publik ka qënë pjesë e trajnimeve të vazhdueshme të organizuara nga Shkolla e Administratës Publike, me tematika të ndryshme në fushën e administratës publike.

Stafi i Burimeve Njerëzore me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 152/2013 "Për Nëpunësin civil" i është nënshtruar një trajnimi intesiv në fushën e shërbimit civil. Gjithashtu, nëpunësit civilë në periudhë prove, konform ligjit i janë nënshtruar trajnimit të detyrueshëm me tematikë "Prezantim me Administratën Publike".

Specialistë në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit kanë marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga ASPA mbi sigurinë kompjuterike.

9.1.2.c Trajnimet e punonjësve të prokurimeve pranë autoriteteve kontraktore.

Agjencia e Prokurimit Publik, me qëllim njohjen e punonjësve të ngarkuar me kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në Autoritetet Kontraktore të pushtetit qendror, në bashkëpunim me Shkollën e Administratës Publike, ka organizuar trajnime në fushën e prokurimit publik.

Në muajin shkurt 2014 APP në bashkëpunim me SIGMA-n, ka zhvilluar, 2 (dy) sesione trajnimi 1 (një) ditore mbi "Marrëveshjen Kuadër". Në këtë trajnim morën pjesë përfaqësues të pushtetit qendror që aplikojnë Marrëveshjen Kuadër. Numri total i pjesëmarrësve 49.

Një vend të veçantë kanë pasur trajnimet mbi konceptet bazë të prokurimit publik, ku APP për tu ardhur në ndihmë specialistëve të sapo emëruar në prokurimin publik ka organizuar në periudhën Prill-Shtator 5 (pesë) sesione trajnimi 2 ditore me tematikë "Bazat e Prokurimit Publik".

Gjithashtu, bazuar në nevojat specifike të Autoriteve Kontraktore, Agjencia e Prokurimit Publik në bashkëpunim me Shkollën e Administratës Publike, ka organizuar sesione trajnime 2 ditore. Në total, tematikat e trajtuara në këto trajnime kanë qënë:

- Bazat e prokurimit
- Prokurimi i Punëve
- Prokurimi i Shërbimeve
- Prokurimi i Mallërave
- Marrëveshja kuadër
- Menaxhimi i kontratave.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten tematikat e veçanta dhe numri i pjesëmarrësve në secilën prej tyre.

Tematika	Numri i të trajnuarve
Bazat e Prokurimit	107
Prokurimi i Shërbimeve	45
Prokurimi i Punëve	40
Prokurimi i Mallrave	41
Marrveshja Kuadër	40
Marrëveshja Kuadër me SIGMA-n	42
Totali	315

9.2 Integrimi

A PP ka vijuar raportimin periodik pranë Ministrisë së Integritit Evropian dhe Strukturave të përbashkëta BE-Shqipëri, në kuadër të procesit të Integritit Evropian dhe detyrimeve që ky proces shoqëron përsa i përket fushës së prokurimit publik.

Në datë 18 Mars 2014 u zhvillua në Tiranë takimi i radhës i Komitetit të Stabilizim Asociimit, ku APP raportoi mbi progresin e arritur, në këtë fushë, për periudhën e kërkuar, kryesisht në drejtim të përafrimit të mëtejshëm të legjislacionit dhe zbatimit të tij, si dhe në drejtim të forcimit të kapaciteteve të institucioneve të përfshirë në rregullimin dhe zbatimin e legjislacionit të prokurimit publik.

Në datë 8 Prill 2014 u zhvillua në Tiranë takimi i përvitshëm i Nënkomitetit Bashkimi Evropian – Shqipëri “Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca, duke përfshirë mbrojtjen e konsumatorit dhe

të shëndetit”, gjatë të cilit APP raportoi në mënyrë më të detajuar mbi progresin e arritur, përsa përmendur më sipër.

Në kuadër të rekomandimeve të nxjerra nga ky takim, u hartua një plan pune në adresim të rekomandimeve përkatëse, për të cilat APP ka raportuar në vijimësi pranë Ministrisë së Integrimit Evropian.

Gjithashtu, në kuadër të raportimit, është përgatitur në nivel kapitulli kontributi për raportin e progresit 2014 të Komisionit Evropian, për Shqipërinë, në fushën e prokurimit publik, ku për kapitullin 5 “Prokurimi publik”, APP është institucioni koordinues.

Në drejtim të përafrimit të mëtejshëm të legjislacionit të prokurimeve me direktivat respektive të Bashkimit Evropian, i cili është një detyrim i ndërmarrë me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (përcaktuar përkatësisht në nenet 70 dhe 74), gjatë këtij viti u përgatitën dhe u miratuan disa ndryshime në ligjin e prokurimit publik (Ligji Nr. 182/2014).

Përpara dërgimit për miratim të draft-ligjit me ndryshimet e sipërcituara, u përgatitën edhe tabelat përkatëse të përputhshmërisë, të cilat përcaktojnë shkallën e përjasjes së secilit nen me pjesët e legjislacionit të Bashkimit Evropian që përafrohen.

APP ka përgatitur edhe pjesën përkatëse për kapitullin 5 “Prokurimi publik”, të përfshirë në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE), 2014-2020. Ky Plan, ndër të tjera, ka të përfshirë prioritetet sipas fushave, si dhe masat legjislative afat shkurtra (2014) dhe afatmesme (2015-2016), duke parashikuar në këtë mënyrë jo vetëm përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, por edhe përafrimin me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian dhe zbatimin e tij. PKIE 2014-2020 u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 438, datë 2.7.2014, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, 2014-2020”.

Gjatë vitit 2014, APP, në bashkëpunim me SIGMA-n (Programi për Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit), përgatitën strategjinë mbi sistemin e prokurimit publik në Shqipëri, e cila më pas u përfshi në Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Financave Publike, 2014-2020. Kjo strategji u miratua nga Këshilli i Ministrave në muajin Dhjetor 2014.

Pjesa e prokurimit publik në strategjinë e sipërcituar përcakton qëllimet kryesore në zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të prokurimeve dhe masat e nevojshme për realizueshmërinë e tyre.

Finalizimi i strategjisë për zhvillimin e sistemit të prokurimit publik ka qënë një ndër rekomandimet e Komisionit Evropian, në takimin e Nënkomitetit përkatës BE-Shqipëri, të zhvilluar në vitin 2014.

Gjithashtu, në pjesën e prokurimit publik të përfshirë në strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike të sipërcituar, në adresim të rekomandimit të dhënë gjatë këtij nënkomiteti, si dhe rekomandimit të raportit të progresit 2014 të Komisionit Evropian, në këtë fushë, është parashikuar edhe krijimi i mekanizmave efikasë për koordinimin e sistemeve të prokurimit publik dhe koncesioneve.

Edhe gjatë këtij viti, si anëtare e grupit të punës së udhëhequr nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, për vetëvlerësimin e politikave të Aktit të Biznesit të Vogël, APP ka raportuar dhe ka dhënë komentet përkatëse në lidhje me masat dhe politikat e parashikuara në fushën e prokurimit publik, në kuadër të këtij Akti.

Në datat 9 - 10 Shtator, 2014, u zhvillua në Vlorë Konferenca e Shtatë Rajonale IPA për Prokurimin Publik, e organizuar nga SIGMA.

Qëllimi i kësaj konference ishte shkëmbimi i eksperiencave për prokurimin publik ndërmjet vendeve pjesëmarrëse, si dhe nxitja e njohurive mbi legjislacionin e ri të Bashkimit Evropian për prokurimin publik (Direktivat e prokurimeve të miratuara në muajin Shkurt 2014).

Në këtë organizim, ku APP kishte cilësinë e institucionit pritës, morën pjesë zyrtarë të lartë të prokurimeve nga vendet IPA, përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Tregut të Brendshëm pranë Komisionit Evropian, ekspertë nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, si dhe përfaqësues të organizatave të tjera ndërkombëtare në rajon: Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Shkolla Rajonale e Administratës Publike, Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), etj.

9.3 Gjendja financiare e Agjencisë së Prokurimit Publik për vitin 2014

Agjencia Prokurimit Publik në zbatim të ligjit nr.185/2013, datë 28.12.2013 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2014”, për vitin 2014 ka marrë fonde nga buxheti i shtetit, si më poshtë:

Në 000/lekë

	Emërtimi	Plan vjetor 2014	Akt normativ 2014	Fakt 2014	Në %	Në vlere
1	Shpenzime paga	21 494	21 494	19 704	91.7	1790
2	Sigurime Shoqërore	3 403	3 403	3 138	92.2	265
3	Mallra Shërbime	22 500	19 000	15 000	78.9	4000
5	Shpenzime për investime	6 000	6 000	3 886	64.8	2114
	Totali i shpenzimeve	53 397	49 897	41 728	83.6	8169

Konkluzioni kryesor që nxirret nga analizimi i tabelës së mësipërme, është se shpenzimet e përgjithshme të APP-së, në fund të vitit 2014, janë realizuar në masën 83.6 përqind, ose rreth 8 169 00 lekë më pak se plani i ndryshuar me aktin normativ në fund të vitit.

Konkretisht përqindja e shpenzimeve sipas zërave paraqitet si më poshtë:

	Struktura në %	Buxheti 2014
1	Paga	43.2
2	Sigurime Shoqërore	6.8
3	Mallra Shërbime	38
4	Shpenzime kapitale	12
	Totali i shpenzimeve	49 897

Shpenzimet me fondet e buxhetit u realizuan në zërin shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore përkatësisht 91.7% dhe 92.2%, ndërkohë që shpenzimet operative u realizuan 78.9%, dhe në investime 64.8%.

Mosrealizimi në masën 100% i fondit të akorduar për paga dhe sigurime shoqërore, erdhi për arsye të mosplotësimit të numrit të punonjësve, nga 23 të miratuar, në 21 punonjës në fakt, për një periudhë rreth 7 mujore.

Peshën kryesore në shpenzimet operative e zë zëri shpenzime për mirëmbatjen e sistemit, në nivelin 68.7% të totalit të shpenzimeve të planifikuara, ose 81.8% të shpenzimeve të realizuara.

Nga shpenzimet e parashikuara, nuk u realizuan në masën 100% shpenzimet për mirëmbatje objekti, rrjeti elektrik, pajisje kompjuterike, kondicionerë, shpenzime udhëtimi etj.

Është për t'u theksuar fakti se në kursimin e fondeve të shpenzimeve operative ka ndikuar edhe kryerja e procedurave online për prokurimet me vlerë të vogël, duke mos konsumuar fondin sipas parashikimit.

Investimet nga 6 000 000 lekë fonde të akorduara në fillim të vitit, u realizuan në masën 64.8%, ose në vlerën 3 886 000 lekë, të cilat u shpenzuan për blerje pajisje elektronike sipas parashikimit. Theksojmë se kursimi i fondit në masën 35.2% rezultoi nga procedura e prokurimit publik.

Përsa i përket kontabilitetit dhe mbatjes së llogarive sintetike dhe analitike, veprimet kontabël janë kryer konform dispozitave ligjore në fuqi, edhe detyrimet debitore dhe kreditore janë ndjekur sistematikisht.

APP nuk ka fatura të papaguara për shërbime të kryera gjatë vitit 2014.

10. MARRËDHËNIET E APP-SË ME TË TRETËT

Gjatë vitit 2014, përveç komunikimeve shkresore, nëpunësit e APP-së, u kanë dhënë shpjegime dhe këshilla përfaqësuesve të institucioneve dhe në takime të zhvilluara në ambjentet e APP-së. Gjatë këtij viti, nëpunësit e APP-së kanë pritur në takime përfaqësues të Autoriteteve Kontraktore dhe Operatorëve Ekonomikë. Këto takime janë zhvilluar me Drejtorin e Përgjithshëm si dhe me përfaqësues të Drejtorisë Juridike, të Monitorimit dhe Publikimit dhe të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit.

11. PËRMBYLLJE

Nga analiza e punës së Agjencisë së Prokurimit Publik gjatë vitit 2014 dhe angazhimet e saj në fund të vitit 2013 (të shprehura në analizën e vitit 2013 për vitin në vijim), vihet re se këto angazhime janë përmbushur, edhe pse ishin shumë ambicioze, pasur në konsideratë numrin e stafit të APP.

Në mënyrë të përmbledhur, arritjet kryesore të APP gjatë vitit 2014, kanë qënë:

- U hartua Strategjia për Sistemin e Prokurimit, e cila u përfshi në Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Financave Publike, 2014-2020, dhe u miratua si e tillë me Vendim të Këshillit të Ministrave;
- U realizua monitorimi i 82 procedurave të prokurimit në 52 Autoritete Kontraktore dhe i 1 procedure koncesionare;
- U realizua procesi *upgrade* i sistemit të operimit dhe të databazës, të cilët tashmë operojnë me Windoës 2012 R2 dhe SQL Server 2008. Si rezultat i këtij procesi, në termat e teknologjisë së informacionit, SPE ka pësuar rritje të performancës dhe sigurisë së informacionit;
- U realizua shërbimi i *Upgrade dhe implementimi i zgjidhjes Back Up me tape* për SPE, duke rritur në këtë mënyrë sigurinë e të dhënave që ruhen në të;
- U realizua rritja e kapaciteteve hardware të serverave (shtimi i RAM) dhe përmirësimi i vazhdueshëm i ndërfaqes, me qëllim përmirësimin dhe lehtësimin e punës së përdoruesve të SPE;
- U realizua përmirësimi i sigurisë së SPE dhe Sistemit të Arkivës Elektronike;
- U realizua trajnimi i 315 zyrtarëve të ngarkuar me kryerjen e procedurave të prokurimit publik, pranë Autoriteteve Kontraktore.

Përveç sa më sipër, gjatë vitit 2014, APP ka realizuar dhe objektiva të tjera përtej këtyre angazhimeve, ku si më të rëndësishme theksojmë, ndryshimet ligjore dhe nënligjore të përfunduara në muajin Dhjetor 2014, sikurse kemi analizuar në mënyrë të detajuar më sipër në këtë analizë.

Përmbushja e këtyre angazhimeve vjen në të njëjtën linjë dhe me rekomandimet e shprehura në Progres Raportin e Komisionit Evropian në fund të vitit 2013, rekomandime të cilat janë fokusuar kryesisht në nevojën për ngritjen e kapaciteteve administrative dhe profesionalizmit të zyrtarëve të ngarkuar me kryerjen e procedurave të prokurimit publik.

Përveç sa më sipër, gjatë vitit 2014, APP-ja, jo vetëm ka vazhduar të administrojë me sukses sistemin e prokurimit elektronik, duke bërë të mundur që të gjitha procedurat e prokurimit të zhvillohen në të, por edhe ka arritur që të përmirësojë funksionalitet e këtij sistemi sikurse është analizuar më sipër.

Megjithatë puna për mirëmbajtjen e sistemit dhe administrimin e të gjithë infrastrukturës së nevojshme për aplikimin e një sistemi të tillë nga Autoritetet Kontraktore si dhe përmirësimin e tij të vazhdueshëm, është ende një sfidë me të cilën APP-ja do të vazhdojë të përballet dhe gjatë vitit 2015.

Si tregues të rezultateve të punës së APP-së si dhe të sistemit të prokurimit publik në përgjithësi, janë dhe statistikatat e gjeneruara nga sistemi elektronik i prokurimit, ku del qartë numri i procedurave të zhvilluara, numri i lartë i pjesëmarrësve, si dhe fondi i kursyer në këto procedura.

Treguesit e vitit 2014 në fushë, janë rritur ndjeshëm nga ato të përmendura në progres raportin e Komisionit Evropian të vitit 2014, tregues të cilët i referoheshin vitit 2012 dhe vitit 2013. Kështu gjatë vitit 2014:

- është rritur numri i procedurave të zhvilluara, krahasuar me vitin 2013;
- është rritur ndjeshëm numri i procedurave të monitoruara, krahasuar me vitin 2013;
- është rritur numri dhe masa e gjobës si dhe numri i masave disiplinore, të vendosura, krahasuar me vitin 2013;
- është rritur numri i çështjeve gjyqësore të fituara, krahasuar me vitin 2013;
- është ulur sasia e fondit limit të prokuruar me procedurën me negociim pa shpallje paraprake, krahasuar me vitin 2013.

Të gjitha rezultatet e sipërpërmendura janë arritur, megjithë numrin relativisht të vogël të stafit, krahasuar me detyrat që ky institucion ka në bazë të legjislacionit të prokurimit publik, legjislacionit të koncesioneve dhe PPP-ve dhe legjislacionit të ankandit publik.

Megjithatë ngelen ende rekomandime që duhen përmbushur, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të prokurimit publik në Shqipëri dhe ndër më kryesori prej tyre, në progres raportin si më sipër mbetet integrimi i sistemit të prokurimit me sistemin e buxhetit, me qëllim rritjen e efikasitetit të prokurimit publik, integrimi i sistemit të prokurimit me sistemin e koncesionit si dhe forcimi i kapacitetit të APP-së dhe autoriteteve kontraktore, për të siguruar zbatimin me efektivitet të legjislacionit prokurimit.

Megjithë progresin dhe arritjet e bëra gjatë vitit 2014, për realizimin e detyrave dhe përmbushjen e mëtejshme të angazhimeve të ndërmarra në fushën e prokurimit publik, për vitin 2015 APP ka një sërë prioritetesh, për të cilat duhet të punojë. Ndër to si më kryesoret, theksojmë:

- Shtimin e stafit të Agjencisë së Prokurimit Publik, dhe rishikimin e strukturës së saj, me qëllim riorganizimin e punës për të rritur në maksimum performancën në realizimin e detyrave ligjore;
- Stimulimin e përdorimit të Marrëveshjes Kuadër, si një mjet që siguron konkurrencën dhe transparencë në kryerjen e procedurave të prokurimit, edhe në rastet e situatave të paparashikuara. Përdorimi i këtij mjeti, do të ndikonte drejtpërsëdrejti dhe në uljen e rasteve të përdorimit të procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit;

- Minimizimin e rasteve të përdorimit të procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit;
- Rritjen e numrit të monitorimeve të procedurave të prokurimit, me qëllim monitorimin e zbatueshmërisë së ligjit të prokurimit dhe udhëzimin e autoriteteve kontraktore për përmirësimin e veprimtarisë së tyre në këtë drejtim, në të ardhmen;
- Trajnimin e zyrtarëve të ngarkuar me kryerjen e procedurave të prokurimit, pranë autoriteteve kontraktore, me qëllim ngritjen e kapaciteteve administrative, për rritjen e performancës së AK në këtë drejtim. Ky aktivitet bëhet i domosdoshëm në kushtet kur legjislacioni i prokurimit publik ka pësuar ndryshime të ndjeshme;
- Krijimi dhe implementimi i portalit të ri të Agjencisë së Prokurimi Elektronik, me qëllim lehtësimin e përdorimit të tij dhe aksesin në informacion nga çdo i interesuar;
- Zhvillimi dhe përmirësimi i mëtejshëm i Sistemit të Prokurimit Elektronik nëpërmjet “Shërbimit të Automatizimit të Ekstrakteve historikë të thjeshtë” nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, me qëllim minimizimin e dokumentave të ngarkuara në këtë sistem;
- Rritje e sigurisë së aksesit në sitemin e prokurimit elektronik për operatorët ekonomikë, në dhënien e kredencialeve të log-in;
- Përmirësimi i funksionalitetit të arkivës elektronike, si dhe rritja e kapaciteteve për të përballuar numrin në rritje të procedurave të prokurimit që zhvillohen në platformën e sistemit të prokurimit elektronik;
- Rritje e sigurie së transmetimit të të dhënave nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik;
- Rritje e sigurisë fizike të paisjeve hardware, përfshirë dhe krijimin e një mjedisi të sigurtë për ruajtjen e backup-it.